



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 161, datë 06.04.2023

PËR

VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...} PËR VITIN 2021

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, për vitin 2021”, i hartuar nga relatore znj. Irena Plaku,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...} për vitin 2021”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Në drejtim të përcaktimit të fakteve të çështjes, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja parashtron në mënyrë të detajuar faktet e çështjes, në një pjesë të veçantë dhe të dallueshme të pjesës përshkruese-arsyetuese të titulluar “Rrethanat e çështjes”. Faktet gjenden të pasqyruara edhe në pjesën e pretendimeve përkatëse të palëve, të cilat janë të përshkruara në mënyrë të mëvetësishme në pjesë të veçanta të vendimit. Gjithashtu evidentohet se faktet gjenden edhe te nëndarja e vlerësimit ligjor të gjykatës mbi bazueshmërinë në ligj dhe në prova të pretendimeve të ngritura mbi bazën e ankimit.

Paraqitja e fakteve të çështjes, duke iu referuar vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja apo atyre të përzgjedhura me short, nxirret nëpërmjet analizës së integruar të provave të administruara gjatë gjykimit në shkallë të parë si dhe në pjesën e vlerësimit ligjor të Gjykatës Administrative të Apelit.

Evidentohet kujdesi i duhur që gjyqtarja tregon për cilësimin e saktë të veprimeve që përbëjnë fakte juridike, pavarësisht nëse përcaktimi i gabuar ose jo i faktit, ka përbërë ose jo shkak ankimi. Kjo, sepse përcaktimi i saktë i faktit lidhet prej saj në çdo rast me analizimin e shkaqeve të ankimit dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjeve, në vendimet e analizuara, evidentohet se gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve. Identifikon natyrën administrative të çështjes objekt gjykimi, duke specifikuar se me çfarë lidhet mosmarëveshja objekt gjykimi. Identifikimi i natyrës së mosmarëveshjes orienton gjykatën në përcaktimin e legjislacionit të zbatueshëm duke referuar në ligjin përkatës.

Identifikimi i natyrës së çështjes konstatohet edhe në vlerësimin e gjykatës lidhur me kushtet e pranueshmërisë së ankimit. Për këtë qëllim gjyqtarja citon dhe aplikon mbi rrethanat procedurale nenet përkatëse të K.Pr.Civile dhe të ligjit nr.49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe gjykimin e mosmarëveshjeve administrative” lidhur me afatin e ankimit,

elementët e ankimit, njoftimin dhe dërgimin e ankimit për shqyrtim, si dhe konstatimin e veprimeve apo mosveprimeve të cilat do të përbënin shkak për prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në vendimet burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke cituar në përmbajtjen e vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material, të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural, apo zgjidhjen në themel të çështjes.

Sa i përket ligjit procedural, gjyqtarja ka referuar dhe cituar në disa raste:

- nenet 44, 45, 46, 48, 50/ç, 54 dhe të ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar dhe nenet 443, 444, 447 dhe 476 të K.Pr.Civile në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së ankimit, lidhur me afati ankimit, elementët e ankimit, njoftimin dhe dërgimin e ankimit për shqyrtim, si dhe konstatimin e veprimeve apo mosveprimeve, të cilat do të përbënin shkak për prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim¹;
- nenet 3/b, 9/1, 1.6/a,c, 13/1, 21/1, 23/11,12, 30/1,2, 33/1/a, 2/a të ligjit nr.139.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në analizë të pretendimit të ngritur në ankim mbi mungesën e legjitimitetit pasiv, me qëllim analizimin e misionit të organeve të qeverisjes vendore, funksionet e veta dhe ato të deleguara, të drejtat dhe detyrimet që marrin përsipër si persona juridik publik në bazë të ligjit dhe marrëdhënieve juridike që krijojnë me personat e tjerë juridik publik apo privat, detyrimin për t’ju nënshtruar Kushtetutës, akteve ndërkombëtare dhe kuadrit ligjor që i ngarkon detyrime etj²;
- nenet 3/3, 11 dhe 109 të K.Pr.Administrative.³ në lidhje me diskrecionin e organit publik, kushtet kur ushtrohet dhe rastet kur një akt administrativ është i paligjshëm;
- nenet 1 pika 2, 17, 50/ç të ligjit nr.49/2012201 si dhe nenin 185 të K.Pr.Civile, lidhur me llojet e ngritjes së padisë, vendimarrjen e Gjykatës së Apelit Administrativ për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë si dhe të drejtën e paditësit për shtimin e objektit të padisë dhe fazën në të cilën ligji ka parashikuar mundësinë për saktësimin apo ndryshimin e objektit të padisë⁴;
- nenin 113 të K.Pr.Administrative lidhur me paligjshmërinë e aktit administrativ.⁵
- nenit 7 dhe 10 të ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” në lidhje me juridiksionin gjyqësor dhe kompetencën lëndore dhe funksionale⁶ si edhe nenet 28, 28/3, 29 dhe 30 të ligjit nr.49/2012 në lidhje me kompetencën për marrjen në shqyrtim të kërkesës për marrjen e masës së sigurimit të padisë, mbi kriteret ligjore të sigurimit të padisë dhe llojeve të sigurimit të padisë⁷;
- nenin 129 të K.Pr.Administrative si dhe nenin 16 pika 2 të ligjit nr.49/2012, lidhur me ankimin administrativ⁸;

¹Vendimi nr.602, datë 01.12.2021, vendimi nr.427, datë 14.09.2021, vendimi nr.330, datë 11.06.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit

² Vendimi nr.602, datë 01.12.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

³ Vendimi nr.427, datë 14.09.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

⁴ Vendimi nr.598, datë 01.12.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

⁵ Vendimi nr.333, datë 11.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

⁶ Vendimi nr.330, datë 11.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

⁷ Vendimi nr.48, datë 24.11.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

⁸ Vendimi nr.330, datë 11.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

- nenin 459 të K.Pr.Civile në lidhje me rënien në dekadencë të kërtimeve të paankimuar në apel⁹;
- nenin 17/2 të ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar në lidhje me cilësimin e saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen¹⁰.

Sa i përket dispozitave të ligjit material të zbatueshëm, gjyqtarja ka identifikuar, referuar, dhe në disa raste ka cituar dispozita të Kodit të Procedurave Administrative dhe të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në çështjet objekt shqyrtimi. Konkretisht, në vendimet e analizuara gjyqtarja referon dispozita të ligjit material, si më poshtë:

- nenet 608, 609, 493, 615, 618, 625 dhe 640 të K.Civil që lidhen me përgjegjësinë juridiko-civile të punëdhënësit nga shkaktimi i dëmit pasuror dhe jopasuror si dhe ligjin nr.8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”.¹¹
- nenet 5, 36, 62 të ligjit të posaçëm nr.9863/2008 “Për ushqimin”, lidhur me komunikimin e riskut, kërkesat e përgjithshme të etiketimit të riskut, fushës së veprimtarisë së AKU-së, urdhërin nr.377, datë 05.09.2017 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Riskut” dhe VKM-në nr.1344, datë 10.10.2018 “Për miratimin e rregullave “Për etiketimin e produkteve ushqimore” me qëllim analizimin e procedurës së etiketimit të produkteve.¹²
- nenin 8 të ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, nenin 3/11 të ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, nenet 45 dhe 53 të ligjit nr.8405/1998 “Për urbanistikën” në lidhje me shkaqet kur bëhet shpronësimi, kuptimin e termit “infrastrukturë publike”, lejen e ndërtimit dhe përfituesit e lejes së ndërtimit.¹³
- nenet 57-60, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, lidhur me përgjegjësinë për masat disiplinore, llojet e masave disiplinore, kompetencat dhe procedura për marrjen e masave disiplinore si dhe parimet për përshkallëzimin dhe individualizimin e masave disiplinore¹⁴ dhe nenin 67/3 lidhur me procedurën e rekrutimit të nëpunësve civilë ekzistues¹⁵.
- nenin 41 të ligjit nr.108/2014 “Për policinë e shtetit” (pranimi në funksione ndihmëse të policisë), pikën 1 dhe 2, Kreu II të VKM-së nr.116, datë 05.03.2014 me qëllim dhënien e konsideratave juridike të termave “nëpunës civilë” dhe “punonjës ekzistues”.¹⁶
- nenin 35 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, lidhur me natyrën e vendimeve të marra nga KMCAP pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore si dhe “Rregulloren për organizimin, të drejtat, detyrat dhe funksionimin e komisioneve mjekësore të caktimit të aftësisë për punë të invalidëve” lidhur me kompetencat për përcaktimin e kohës së invaliditetit¹⁷.

⁹ Vendimi nr.273, datë 12.05.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

¹⁰ Në të gjitha vendimet e marra në shqyrtim

¹¹ Vendimi nr.602, datë 01.12.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

¹² Vendimi nr.633, datë 29.12.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

¹³ Vendimi nr.427, datë 14.09.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

¹⁴ Vendimi nr.633, datë 29.12.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

¹⁵ Vendimi nr.333, datë 11.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

¹⁶ Vendimi nr.633, datë 29.12.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

¹⁷ Vendimi nr.330, datë 11.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

- nenet 144 paragrafi 5/1, 140, 141-148, 149-152, 153-158 të K. Punës në lidhje me kohëzgjatjen e kontratave të punës, mënyrat e zgjidhjes së kontratave me afat të caktuar dhe të pacaktuar, procedurën e zgjidhjes, afatet e njoftimit dhe Udhëzimin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 13 prot, datë 15.01.2016 si dhe struktura analitike e kësaj ministrie për vitin 2016¹⁸.

Krahas dispozitave dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

- nenin 41 i Kushtetutës si dhe nenin 1 Protokollin 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore lidhur me të drejtën e pronësisë si një e drejte e garantuar, si dhe rastet e kufizimit të pronësisë private (*shpronësimi apo kufizime që barazohen me shpronësimin*);¹⁹
- nenin 42/2 të Kushtetutës si dhe nenin 6/1 të KEDNJ, lidhur me të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.²⁰

Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave, në vendimet e analizuara nuk rezulton të jetë evidentuar ndonjë rast i konfliktit të normave me karakter procedural ose material, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e çështjeve.

Vetë gjyqtarja, referuar formularit të vetëvlerësimit, ka deklaruar se *“Aftësinë time profesionale për të përcaktuar faktet e çështjes, identifikuar natyrën e saj, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave sipas rastit e vlerësoj si ‘Shumë e lartë’.* Në çdo çështje gjyqësore identifikoj drejt natyrën e mosmarrëveshjes si edhe ligjin e zbatueshme. Detyra ime kryesore si Gjyqtar është të përcaktoj drejt faktet e çështjes, pasi mbi bazën e këtyre fakteve përcaktohet natyra e çështjes ose thënë ndryshe marrëdhënia juridike në konflikt. Lidhur me aplikimin e ligjit të zbatueshëm, në rastet kur ka patur konflikt ndërmjet normave, kam mbajtur parasysh parimin ‘Lex specialis derogat lex generalis’ si dhe vendimin nr. 2, datë 03.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese. Në arsyetimin e vendimit mbaj parasysh që të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje, sipas përmbajtjes së vendimeve të Gjykatës Kushtetuese me nr.3, dt.26.01.2015 dhe nr.63, dt.23.09.2015 ilustruar me praktiken gjyqësore të detyrueshme për zbatim.

Në funksion të natyrës së çështjes, vlerësoj se në çdo rast kam identifikuar saktë dispozitat ligjore të zbatueshme. Identifikimi i dispozitave ligjore pasqyrohet, në çdo veprim të kryer, si në vendimet e ndërmjetme dhe në ato përfundimtare.”

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira për identifikimin dhe analizën e qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë koncize, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e

¹⁸ Vendimi nr.273, datë 12.05.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

¹⁹Vendimi nr.427, datë 14.09.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

²⁰ Vendimi nr.330, datë 11.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu, gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e saj, bazuar në shkaqet e ankimit.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarës në lidhje me treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.*

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet t'i japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material dhe procedural të zbatueshëm.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se në vendimet objekt vlerësimi, identifikimi i normës juridike si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështje. Në çdo rast citimi i dispozitave integrohet me një fakt të caktuar apo me konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin ligjor të normës konkrete (*ratio legis - për të cilën ajo është krijuar*) dhe, duke e përputhur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, arrin në konkluzionin në lidhje me shkaqet e ankimit apo për t'i dhënë përgjigje pretendimeve të palëve në rastet kur ato kanë qasje tjetër ndaj qëllimit të ligjit. Gjithashtu konstatohet edhe interpretimi i normës juridike në këndvështrimin sistematik të tyre, apo në këndvështrimin historik (*ndryshimet e ligjeve*), duke u ndalur në krahasimin e formulimit të dispozitës para dhe pas ndryshimeve që ajo ka pësuar. Në të gjitha vendimet gjyqësore dispozitat ligjore të evidentuara si të nevojshme për zgjidhjen e çështjes, shoqërohen me interpretimin e kuptimit dhe qëllimit të tyre, para aplikimit mbi faktet konkretet në shërbim të të cilit ato analizohen.

Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm, evidentohet se interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejnë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës. Interpretimi i normës

lidhet gjithmonë me faktet e provuara. Konkretisht, në mënyrë më specifike në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi, evidentohet se gjyqtarja:

- interpreton në mënyrë të përgjithshme ligjin organik nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i cili ka qenë në fuqi në kohën kur ka ndodhur ngjarja), që rregullon organizimin, funksionimin dhe përgjegjësinë administrative të njësisve të qeverisjes vendore në analizë të pretendimit të ngritur në ankim mbi mungesën e përgjegjësisë së palës së paditur me personat që përfitojnë ndjekjen e programeve të arsimit parashkollor në kopshte dhe çerdhe. Gjyqtarja ndalet në interpretimin e nenit 3 të këtij ligji (lidhur me misionin e vetëqeverisjes vendore) dhe nenit 9 pika 1.1/a dhe 1.6 (lidhur me të drejtat dhe përgjegjësitë e njësisve të vetëqeverisjes vendore)²¹;
- Interpreton nenet 608 dhe 609 të K.Civil lidhur me kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative për lindjen e marrëdhënies së detyrimit, që rrjedh nga shkaktimi i dëmit jashtëkontraktor. Në vijim të kësaj analize gjyqtarja interpreton në mënyrë literale pikën 1 të nenit 608 të K.Civil, me qëllim analizimin e konceptit juridik të *paligjshmërisë* së veprimit apo mosveprimit, i cili ka shkelur të drejtat apo interesat e një të treti. Në këtë kontekst gjyqtarja interpreton edhe nenin 3 të ligjit nr.8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, në lidhje me rastet e përgjegjësisë së organeve shtetërore²²;
- Interpreton në mënyrë sistematike nenet 625 dhe 640 të K.Civil, lidhur me përgjegjësinë civile që rrjedh nga shkaktimi i dëmit pasuror dhe jopasuror si dhe të drejtën e dëmshpërblimit të këtij dëmi²³;
- Interpreton në mënyrë të përgjithshme ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, duke argumentuar se ky ligj parashikon rregullime të posaçme që zbatohen në marrëdhëniet e punës së nëpunësit civil me status me punëdhënësin. Në këtë kontekst duke bërë një interpretim të përgjithshëm të qëllimit të ligjit, gjyqtarja argumenton se ky ligj parashikon në mënyrë shteruese kushtet dhe procedurat e pranimit në shërbimin civil, mënyrën e fitimit dhe mbarimit të marrëdhënies së punës, zhvillimin e karrierës për garantimin e të drejtave dhe përcaktimin e detyrimeve të nëpunësit civil, vlerësimin e ecurisë në punë me synim krijimin e shërbimit civil të qëndrueshëm, profesional dhe eficient²⁴;
- Interpreton nenin 5 me nenin 62 të ligjit nr.9863/2008 “Për Ushqimin”, lidhur me fushën e veprimtarisë së AKU-së dhe detyrimet e saj ligjore për analizimin, vlerësimin dhe komunikimin e riskut nga ana e strukturave përgjegjëse të AKU-së dhe nenet 1, 2 dhe 36 të po këtij ligji me dispozitat e VKM-së nr.1344, datë 10.10.2018 “Për miratimin e rregullave “Për etiketimin e produkteve ushqimore”²⁵;
- Interpreton nenin 22 të Urdhrit nr.377, datë 05.09.2017 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Për miratimin e rregullorës së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e AKU-së”, me qëllim analizimin e detyrave funksionale të Drejtorit të Drejtorisë së Vlerësimit të Riskut dhe nenet 2 dhe 6 të ligjit nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” lidhur me qëllimin e auditimit të brendshëm dhe rolin të tij²⁶;

²¹ Vendimi nr.602, datë 01.12.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

²² Po aty

²³ Po aty

²⁴ Vendimi nr.633, datë 29.12.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

²⁵ Po aty

²⁶ Po aty

- interpreton në mënyrë literale nenin 3/11 të ligjit nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” me qëllim dhënien e konceptit juridik të interesit publik dhe nenet 45 dhe 53 të ligjit nr.8405/1998 “Për urbanistikën” për të analizuar konceptin, formën dhe procedurën e Lejës së Ndërtimit, si një akt të posaçëm me të cilin duhet të jetë i pajisur çdo subjekt ndërtues për të kryer një ndërtim²⁷;
- nenin 7 të Kushtetutës në funksion të argumentimit se gjykata nuk mund të vlerësojë përshtatshmërinë apo oportunitetin e politikave të zhvillimit të qyteteve ose të zonave të caktuara të ndërmarra nga organet publike, pasi ajo do të ndërhynte në pushtetin ekskluziv të organeve të pushtetit ekzekutiv mbi hartimin e politikave të zhvillimit (duke referuar në *parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve*)²⁸;
- nenin 35 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH” (dhe në tërësi frymën e ligjit) lidhur me natyrën e vendimit të KMCAP-it epror, në funksion të argumentimit se ky vendim është i formës së prerë, çka tregon se ndaj këtij akti administrativ pala vjen drejtëpërdrejt në gjykatë²⁹;
- nenet 140, 141-148, 149-152 të K.Punës, lidhur me zgjidhjen e kontratës së punës (*formën, afatet, procedurën, shkaqet e justifikuara dhe pasojat juridike në rastin e zgjidhjes së menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara*)³⁰.

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale, gjyqtarja interpreton dispozitat në disa raste, si më poshtë:

- nenin 12 të K.Pr.Administrative në kuadër të analizimit të natyrës së shkeljeve që i atribuohen paditësit nga punëmarrësi duke shtruar për diskutim raportin proporcional midis shkeljeve të konstatuara në raport me masën e marrë ndaj paditësit duke referuar në *parimin e proporcionalitetit*³¹;
- nenet 3/3 dhe 11 të K.Pr.Administrative duke referuar në *parimin e ushtrimit të diskrecionit*³²;
- nenet 1, 17, 50/ të ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” me nenin 185 të K.Pr.Civile duke argumentuar se neni 1, pika 2 e ligjit nr.49/2012 thërret zbatimin në mënyrë komplementare të parashikimeve ligjore të K.Pr.Civile në të gjitha rastet kur lex specialis i gjykimit administrativ nuk parashikon ndryshe apo kur parashikon përjashtimin e zbatimit të ligjit procedural civil. Gjithashtu në vazhdim të këtij arsytimi gjykata interpreton nenin 185 të K.Pr.Civile duke argumentuar se ligjvënësi i njej mundësinë palës paditëse që të saktësojë apo ndryshojë objektin e padisë, por gjithmonë duke respektuar disa kërkesa procedurale, veçanërisht detyrimin që ky ndryshim të bëhet vetëm gjatë hetimit gjyqësor³³;
- nenin 113 të K.Pr.Administrative lidhur me procedurën dhe pasojat e anullimit dhe shfuqizimit të aktit administrativ³⁴;
- nenet 28, 29 dhe 30 të ligjit nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” me qëllim dhënien e konsideratave të përgjithshme

²⁷ Vendimi nr.427, datë 14.09.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

²⁸ Po aty

²⁹ Vendimi nr.330, datë 11.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit,

³⁰ Vendimi nr.273, datë 12.05.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

³¹ Vendimi nr.633, datë 29.12.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

³² Vendimi nr.427, datë 14.09.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

³³ Vendimi nr.598, datë 01.12.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

³⁴ Vendimi nr.333, datë 11.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

juridike lidhur me kushtet ligjore të sigurimit të padisë, natyrës procedurale të kësaj kërkesë dhe llojeve të sigurimit të padisë³⁵;

- Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante.

Nga vendimet burim vlerësimi, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Administrative dhe Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, vendimet e GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- në funksion të evidentimit të faktit se autoritetet shtetërore kanë detyrimin për marrjen e masave për mbrojtjen e jetës së qytetarëve nga ngjarje të rrezikshme dhe se mungesa e një sistemi supervizimi koherent dhe të vazhdueshëm në një zonë të rrezikshme përbën sipas GEDNJ shkelje të nenit 2 të KEDNJ dhe përgjegjësi të shtetit në formën e neglizhencë ka referuar çështjen “*Onderyldis kundër Turqisë*” të GJEDNJ³⁶;
- për të forcuar argumentin se gjykata nuk mund të vlerësojë përshtatshmërinë apo oportunitetin e politikave të zhvillimit të qyteteve ose të zonave të caktuara të ndërmarrja nga organet publike, pasi gjykata do të ndërhynte në pushtetin ekskluziv të organeve të pushtetit ekzekutiv mbi hartimin e politikave të zhvillimit, ka referuar qëndrimin e mbajtur nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vendimin nr.00-2017-479(174), datë 28.03.2017³⁷;
- me qëllim përcaktimin e fazës procedurale brenda së cilës palës i jepet mundësia për saktësimin apo ndryshimin e objektit të padisë, ka referuar vendimin nr. 3, datë 24.0.12017 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe në vendimin nr.00-2020-265(6), datë 01.07.2020 të mbajtur po nga ky Kolegj në lidhje me trajtimin e punonjësve, marrëdhëniet e punës së të cilëve rregullohen me ligjin e posaçëm³⁸;
- lidhur me përcaktimin e kritereve ligjore për marrjen e masës së sigurimit të padisë në mbështetje të argumentit të saj ka referuar vendimin nr.763, datë 02.06.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë si dhe vendimin nr.801, datë 03.06.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për të përforcuar argumentet e saj mbi çështjen, dhe në funksion të argumentimit se pala kërkuese nëpërmjet kërimit për marrjen e masës së sigurimit të padisë nuk po kërkon të arrijë atë që ka në thelb të kërimit të saj për zgjidhjen e çështjes në themel referon vendimin unifikues nr.10, datë 24.03.2004 të Gjykatës së Lartë³⁹;
- Në vendimin nr.330, datë 11.06.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit, ka referuar çështjen “*Dauti kundër Shqipërisë*” (vendim i Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut i datës 03.02.2009), ku ndër të tjera thuhet se Komisioni i Ankimeve nuk përbën “*një gjykatë të pavarur dhe të paanshme*”, në funksion të analizës se personin nuk mund t’i kufizohet aksesin në gjykatë, parim ky i sanksionuar në nenin 42/2 të Kushtetutës si dhe nenit 6 të Konventës, duke konkluduar se ka shkelje të nenit 6/1 të Konventës si dhe referon në praktikën e Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë (pa e specifikuar vendimin) në funksion të analizës së të drejtës për pension, e cila

³⁵ Vendimi nr.48, datë 24.11.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

³⁶ Vendimi nr.602, datë 01.12.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

³⁷ Vendimi nr.427, datë 14.09.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

³⁸ Vendimi nr.598, datë 01.12.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

³⁹ Vendimi nr.48, datë 24.11.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

përfshihet në rrethin e të drejtave themelore të njeriut, që përfshihet në grupin e të drejtave social- ekonomike të garantuar nga aktet ndërkombëtare dhe Kushtetuta;

- referon *Vendimin Unifikues nr.19/2007* në funksion të argumentit se pala e paditur/punëdhënësi mund të zgjidhë kontratën e punës për çfarëdolloj shkak, mjafton të zbatojë përcaktimet e parashikuara në Kodin e Punës, lidhur me procedurën dhe afatin e njoftimit, rrethana këto që do ta shkarkonin atë nga detyrimi për pagimin e dëmshpërblimeve⁴⁰.

-Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës.

Nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i veçantë i gjyqtarës që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referojë dhe zbatojë parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsyetimit të vendimit. Gjyqtarja referon dhe zbaton:

- *në parimin e proporcionalitetit* sipas të cilit çdo veprim administrativ, i cili për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të drejtave të të tjerëve mund të kufizojë një të drejtë individuale ose mund të cënojë interesat legjitime në përputhje me parimin e proporcionalitetit⁴¹;
- *në parimin e shtetit të së drejtës si dhe në parimet për shkallëzimin dhe individualizimin e masave disiplinore*⁴²;
- *në parimin kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve* të sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës në funksion të argumentimit se gjykata nuk mund të vlerësojë përshtatshmërinë apo oportunitetin e politikave të zhvillimit të qyteteve ose të zonave të caktuara të ndërmarra nga organet publike, pasi gjykata do të ndërhynte në pushtetin ekskluziv të organeve të pushtetit ekzekutiv mbi hartimin e politikave të zhvillimit⁴³;
- *në parimin e kontradiktoritetit dhe të barazisë mes palëve* kur ka argumentuar se Gjykata e Shkallës së Parë ka zhvilluar një hetim të plotë e të gjithanshëm gjyqësor në përputhje me ligjin procedural, si dhe ka lejuar një debat gjyqësor të palëve⁴⁴;
- *në parimin e ligjshmërisë* duke argumentuar se është detyrim i organeve të ushtrojnë detyrat e tyre në funksion të interesit më të lartë të individëve përfitues, të cilëve Kushtetuta si dhe legjislacioni i zbatueshëm u njeh dhe garanton të drejtat themelore, siç është e drejta për pension⁴⁵.

Vetë gjyqtarja, referuar formularit të vetëvlerësimit, ka deklaruar se: *“Çmtoj se kam aftësi shumë të lartë për të identifikuar ligjin e aplikueshëm dhe arsyetimin e tij për mënyrën e zbatimit mbi faktet objekt gjykimi. Krahas identifikimit të ligjit të aplikueshëm, çmtoj se kam aftësi shumë të lartë për të zbatuar parimet e përgjithshme të së drejtës materiale dhe procedurale që kanë lidhje me interpretimin e ligjit dhe zgjidhjen e çështjes. Gjithashtu, çmtoj se kam aftësi shumë të lartë për përdorimin e jurisprudencës relevante vendase dhe ndërkombëtare, të praktikës së unifikuar/njësuar të Gjykatës së Lartë, praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së.”*

⁴⁰ Vendimi nr.273, datë 12.05.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

⁴¹ Vendimi nr.633, datë 29.12.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

⁴² Po aty

⁴³ Vendimi nr.427, datë 14.09.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

⁴⁴ Vendimi nr.333, datë 11.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

⁴⁵ Vendimi nr.330, datë 11.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural, apo në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen. Po ashtu, në shumicën e vendimeve burim vlerësimi rezulton kujdesi i shtuar i gjyqtarës për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese dhe të GJEDNJ, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e gjyqtarës lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” është “Shumë lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.B Arsyetimi ligjor

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme, në mënyrë që vendimi të kuptohet jo vetëm nga njohësit e mirë të ligjit.

Në përdorimin e instituteve, parimeve apo të drejtave të palëve në proces, edhe në rastet kur rezulton përdorimi i termave latinë, të cilat janë futur gjithmonë në thonjëza, kuptimi i tyre jepet edhe në gjuhën shqipe.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të faktit, rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Rezultoni në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare dhe disa herë të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi, pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë, paragrafët dhe nënndarjet e arsyetimit të vendimit, në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës.

Vendimet janë të organizuar në nënndarje, të identifikuara me tituj, duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, dhe brenda nënndarjeve, në paragrafë, të cilët lidhen me njëri-tjetrin përmes kronologjisë dhe vazhdimësisë së mendimi.

Vetë gjyqtarja, referuar formularit të vetëvlerësimit, ka deklaruar se: *“Në respektim të një prej parimeve themelore të procesit gjyqësor, siç është ai i përdorimit të gjuhës shqipe në gjykim, çmuj se kam aftësi shumë të lartë për të përdorur thjesht dhe drejtpërdrejt gjuhën shqipe, duke shprehur mendimin qartë dhe me sa më pak fjalë, duke zbatuar saktë rregullat gramatikore dhe atyre të sintaksës, përzgjedhjen e kujdesshme të gjuhës dhe përdorimin i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip. Gjithashtu organizoj paragrafët dhe strukturën e fjalisë për të shprehur kuptimin, përdorimin në mënyrë korrekte dhe konsistente i termave teknikë, me qëllim që vendimi gjyqësor të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje, ku në tërësinë e tij ai të jetë një unitet, në të cilin pjesët përbërëse të jenë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato janë në shërbim dhe funksion të njëra tjetrës.”*

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë të arsytimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike. Pjesët e vendimit fillojnë me tituj, e cila shpreh idenë të mendimit të asaj njësie ose konkluzionit mbi të cilit shtjellohet argumentat mbështetës. Kjo mënyrë e të shkruarit i shërben jo vetëm qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, por dëshmonë qëndrueshmëri dhe rrjedhshmëri të paraqitjes së argumenteve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin *“Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”* është *“Shumë e lartë”* dhe pikëzohet me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsytimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj., të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe

konkluzioni i arritur.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës i përmbahet, si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, interpretimin e tij, aplikimin mbi faktet dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Konkretisht, në përmbajtje të vendimeve evidentohet se vendimet gjyqësore përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin.

- Konkretisht në mënyrë më specifike konstatohet se:

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e plota lidhur me gjykatën, përbërjen e trupit gjykues dhe sekretaren gjyqësore, kohën dhe vendin e zhvillimit të gjykimit, identitetin e palëve, objektin dhe bazën ligjore të padisë, disponimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, si dhe shkaqet e ankimit, duke i rënditur secilën prej tyre në mënyrë llogjike.

Pjesa përshkruese-arsyetuese rezulton që të jetë ndarë në mënyrë të shprehur në disa nën pjesë të titulluara “*Rrethanat e çështjes*”, “*Vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë*”, dhe “*Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit*” në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Në pjesën e parë të titulluar “*Rrethanat e çështjes*” paraqiten rrethanat e faktit, siç kanë rezultuar të provuara nga shqyrtimi gjyqësor në shkallë të parë, duke referuar dhe aktet provuese. Në pjesën e dytë të titulluar “*Vlerësimi i gjykatës së shkallës së parë*”, gjyqtarja pasqyron disponimin dhe arsyet e vendimmarrjes së gjykatës së shkallës së parë, të cilat lidhen me shkaqet e ankimit. Në pjesën e tretë të titulluar “*Vlerësimi i Gjykatës Administrative të Apelit*”, gjyqtarja analizon shkurtimisht në lidhje me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës në shqyrtimin e çështjes, kushtet e pranueshmërisë së ankimit, për të vijuar me vlerësimin dhe arsyet e Gjykatës Administrative të Apelit se pse vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë duhet të ndryshohet apo të lihet në fuqi. Karakteristikë e gjyqtarës është që i jep përgjigje çdo pretendimi të palës, duke i analizuar një e nga një secilin pretendim më vete, duke i ndërthur me faktet dhe provat. Gjyqtarja referon gjithmonë në nenin 17/2 të ligjit 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar në lidhje me cilësimin e saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me mosmarrëveshjen nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Në pjesën urdhëruese të vendimit referohet baza ligjore procedurale e vendimmarrjes, si dhe disponimi për lënien në fuqi apo për prishjen e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë, konform nenit 50/b ose 50/ç të ligjit nr.49/2012, për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi (në varësi të lënies në fuqi apo prishjes së vendimit të shkallës së parë), konform nenit 53/b të ligjit nr.49/2012, për çështjet e shqyrtuara në seancë gjyqësore dhe konform neneve 28-30 të ligjit nr.49/2012 në rastin e shqyrtimit të kërkesës për marrjen e masës së përkohshme të sigurimit të padisë⁴⁶. Gjithashtu, gjen pasqyrim disponimi lidhur me të drejtën e ushtrimit të rekursit, afati i ushtrimit të kësaj të drejte, momenti kur fillon të llogaritet ky afat, si dhe data e shpalljes së vendimit

⁴⁶ Vendimi nr.48, datë 24.11.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

Vetë gjyqtarja, referuar formularit të vetëvlerësimit, ka deklaruar se: “Çmoj se kam aftësi shumë të lartë për të hartuar vendimet gjyqësore duke ndjekur dhe respektuar një strukturë të qartë, të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar. Konkretisht, duke përcaktuar gjykatën që ka gjykuar çështjen, palët, duke u shënuar identiteti dhe cilësia e tyre si paditës, i paditur, objekti i padisë, ankimin, kundërankimin në rastet kur është paraqitur, rrethanat e çështjes, pretendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë (pjesën arsyetuese), konstatimet dhe përfundimet e nxjerra gjatë gjykimit të çështjeve në seancë gjyqësore, provat dhe arsyet në të cilat mbështetet vendimi, dispozitat ligjore në të cilat bazohet vendimi, si dhe pjesën urdhëruese të këtij vendimi, me qëllim që vendimi gjyqësor të konsiderohet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje.

Struktura e vendimeve të mia është diktuar nga nenet 309, 310 të K.Pr.Civile dhe neni 41 i ligjit 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar, Vendimin nr. 33 datë 08.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë si dhe vendimeve të Gjykatës Kushtetuese me nr. 3, dt.26.01.2015 dhe nr. 63, dt.23.09.2015 ilustruar me praktikën gjyqësore të detyrueshme për zbatim.”

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, ndjek rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor dhe përdor një metodë të qartë në strukturimin e vendimit si në aspektin vizual, ashtu edhe në përmbajtje të tij. Në të gjitha vendimet e analizuara, ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecuresisë logjike, nga njëri paragraf në tjetrin dhe nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, i bën vendimet lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme dhe orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjyqtarëve u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, për sa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t’u ankuar.⁴⁷

⁴⁷Vendimi i GJEDNJ, çështja “Hadjanastassiou kundër Greqisë”.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se vendimet gjyqësore dominohen nga proces analitik dhe vlerësues në raport me atë përshkruar të fakteve dhe provave. Gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në paraqitjen dhe analizën e fakteve të çështjes, analizë e cila në vendimet gjyqësore burim vlerësimi është e detajuar dhe e plotë, duke integruar si pjesë e saj provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni mbi provueshmërinë e fakteve konkrete.

Në vendimet burim vlerësimi, duke iu referuar natyrës komplekse ose jo të faktit, analiza e faktit dhe ajo ligjore, zhvillohen në mënyrë logjike, duke paraqitur argumente për secilin shkak ankimi më vete. Norma ligjore zbërthehet sipas qëllimit, duke i dhënë përgjigje shkakt konkret të ngritur në padi apo në ankim, pa zgjatje dhe konfuzion, në rrjedhë logjike me konkluzionin e arritur.

Argumentet ndjekin një linjë arsyetimi e cila zhvillohet në mënyrë dinamike mbi çdo fakt apo çështje të marrë në analizë, duke mbështetur në mënyrë logjike konkluzionin e arritur. Gjyqtarja tregon kujdes të veçantë për të identifikuar dhe analizuar institutet dhe konceptet ligjore të zbatueshme në çështjen konkrete, nëpërmjet një analizë dhe interpretimi individual lidhur me kuptimin e tyre, duke i mbështetur më pas ato edhe me qëndrime të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë apo edhe të GJEDNJ kur është vlerësuar e nevojshme. Në mënyrë konkrete, në disa nga vendimet burim vlerësimi, ka rezultuar se gjyqtarja i ka kushtuar rëndësi të posaçme analizës abstrakte të instituteve, parimeve apo normave ligjore, para aplikimit të tyre mbi faktet konkrete, si p.sh.:

- (i) Gjyqtarja ka referuar doktrinën e të drejtës civile në analizimin e konceptin juridik të *dëmit jashtëkontraktor* si dhe liston në mënyrë të detajuar kriteret që duhen plotësuar në mënyrë kumulative për të qenë përpara këtij instituti. Gjyqtarja jep kuptimin e *paligjshmërisë* së veprimit ose mosveprimit, si dhe referuar të drejtës civile dhe doktrinës juridike jep konceptin juridik të *fajit* si element subjektiv të figurës së dëmit jashtëkontraktor për të vijuar me analizimin e formave të këtij instituti juridik. Ajo e mbështet analizën jo vetëm duke iu referuar fakteve dhe duke mbajtur në vëmendje edhe jurisprudencën e unifikuar të gjykatës së lartë, por duke bërë edhe një trajtim doktrinal në lidhje me dëmin e shkaktuar dhe elementët e tij⁴⁸;
- (ii) Gjyqtarja analizon marrëdhënien shkak – pasojë dhe ka analizuar fajin në formën e neglizhencës, duke konkluduar se pala e paditur ka konsumuar fajin në formën e neglizhencës, pasi në kushtet dhe rrethanat e caktuara mund dhe do duhej ta parashikonte dhe paramendonte pasojat që mund të vinin nga përdorimi i mjeteve të papërshtatshme ose që mund të përbënin rrezik për shëndetin e fëmijëve që ndjekin programet e arsimit parashkollor e për pasojë ajo duhet të dëmshpërblejë paditësat për dëmin e shkaktuar⁴⁹.

Marrëdhënien shkak – pasojë gjyqtarja e merr në analizë të hollësishme edhe në vendime të tjera duke analizuar:

- se pala e paditur megjithëse kishte barrën e provës nuk ka arritur të provojë që paditësi ka kryer shkelje shumë të rënda gjatë ushtrimit të detyrës. Pala e paditur nuk ka arritur të provojë se cilat janë dispozita ligjore që ishin shkelur në mënyrë aq të rëndë nga paditësi që të ishin shkaktuar pasoja. Për pasojë, gjykata ka konkluduar se për sa kohë që nuk provohet se punëmarrësi ka kryer shkelje shumë të rënda gjatë ushtrimit të detyrës, marrja e masës disiplinore

⁴⁸ Vendimi nr.602, datë 01.12.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

⁴⁹ Po aty

“Largimi nga shërbimi civil” vjen në kundërshtim me nenin 60 të ligjit nr.153/2013 “Për nëpunësin civil”⁵⁰;

- konceptet e Lejes së Ndërtimit dhe procedurës së nxjerrjes së saj, interesit publik, diskrecionit administrativ në raport me faktet e çështjes, ka vlerësuar se aktet administrative të nxjerra nga organi publik janë në përputhje me ligjin dhe diskrecionin që i jepet këtij organi e si të tilla janë të pacënueshme në kuptim të nenit 108 të K.Pr.Administrative⁵¹;
 - kuadrin ligjor që normon institutin e sigurimit të padisë, dhe duke analizuar faktet e çështjes, ka vlerësuar se provohet me prova shkresore mundësia e shkaktimit të një dëmi të rëndë dhe të pakthyeshëm dhe të atëçastshëm për kërkuesin, pasi dëmi parashikohet të vij menjëherë ose ardhja e tij është e pashmangshme nëse nuk merret masa e sigurimit të padisë. Në këtë kontekst gjykata ka konkluduar për marrjen e sigurimit të padisë duke pezulluar ekzekutimin e aktit administrativ me të cilin është disponuar për prishjen e objektit të kundërligjshëm⁵²;
 - kuadrin ligjor lidhur me të drejtën për përfitimin e pensionit të invaliditetit, gjykata ka vlerësuar se vendimi i KMCAP-it është marrë në përputhje me ligjin dhe rregulloren. Në këtë kontekst gjykata ka vlerësuar se vendimi objekt shqyrtimi është marrë në përputhje me gjendjen shëndetësore të të siguruarit, referuar kritereve mjekësore të caktimit të aftësisë në punë, nga ku është përcaktuar drejt shkalla e humbjes së aftësisë në punë dhe grupi i invaliditetit, për të konkluduar se akti administrativ objekt shqyrtimi duhet të mbetet në fuqi⁵³;
 - normën relevante mbi kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushë punëdhënësi për të proceduar me zgjidhjen e marrëdhënies së punësimit me punëmarrësin. Gjukata arrin në konkluzionin se zgjidhja nuk ka qenë e menjëhershme, por në respektim të afatit të njoftimit. Duke qenë se punëdhënësi ka respektuar afatin e njoftimit punëmarrësi nuk ka të drejtën e dëmshpërblimit sipas nenit 153 dhe 155 të Kodit të Punës. Sa i përket procedurës gjykata ka vlerësuar se në kushtet kur nga pala e paditur nuk u provua respektimi i saj, kërkimi i paditëses për dëmshpërblim është i mbështetur në nenin 144 të K.Punës⁵⁴.
- (iii) Gjyqtarja shpjegon konceptin juridik të “Lejes së Ndërtimit” dhe analizon në mënyrë të detajuar procedurën e plotë të dhënies së lejes së ndërtimit sipas ligjit nr.8405/1998 (i cili ka qenë në fuqi në momentin kur paditësi është pajisur me Leje Ndërtimi)⁵⁵;
- (iv) Gjithashtu gjyqtarja trajton konceptin e termit “interes publik” duke interpretuar në mënyrë literale nenin 3/11 të ligjit nr.107/2014 dhe konceptin e termit “diskrecionit administrativ” që kanë organet publike në hartimin dhe zhvillimin e projekteve publike, për të cilën gjykata nuk mund të shprehet. Në këtë kontekst gjyqtarja ka analizuar se gjykata nuk mund të vlerësojë përshtatshmërinë apo oportunitetin e politikave të zhvillimit të qyteteve ose të zonave të caktuara të ndërmarra nga organet publike, pasi kështu gjykata do të ndërhynte në pushtetin ekskluziv të organeve të pushtetit ekzekutiv mbi hartimin e politikave të zhvillimit.

⁵⁰ Vendimi nr.633, datë 29.12.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

⁵¹ Vendimi nr.427, datë 14.09.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

⁵² Vendimi nr.48, datë 24.11.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

⁵³ Vendimi nr.330, datë 11.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

⁵⁴ Vendimi nr.273, datë 12.05.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

⁵⁵ Vendimi nr.427, datë 14.09.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit

- (v) Gjyqtarja analizon gjerësisht konceptin e të drejtës për pension në kuadër të legjislacionit të brendshëm dhe atij ndërkombëtar. Në këtë kontekst gjyqtarja ka analizuar se e drejta për përfitimin e pensionit të pleqërisë ashtu edhe pensioni i invaliditetit hyjnë në rrethin e të drejtave themelore të njeriut, që përfshihet në grupin e të drejtave social-ekonomike të garantuara nga aktet ndërkombëtare dhe nga Kushtetuta. Më tej gjyqtarja analizon të drejtën për pension si një të drejtë të paparashkrueshme, që nuk mund të kufizohet përveç rasteve të parashikuara shprehimisht në ligj dhe që ka karakter pozitiv që nënkupton detyrimin e organeve të administratës shtetërore të krijojë të gjitha mundësitë dhe kushtet për gëzimin e plotë të tij nga ana e subjekteve përfitues. Analizon konceptin e të drejtës për t'ju drejtuar gjykatës (të drejtën e aksesit) duke pasqyruar edhe qëndrimin e mbajtur nga GJEDNJ.⁵⁶;

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, rezulton se ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor. Në të gjitha çështjet e shqyrtuara, shkaqet e ankimit merren në analizë nga ana e gjyqtarës dhe ju jepet në çdo rast përgjigje e argumentuar në aspektin e mbështetjes në ligj apo prova të tyre.

Vetë gjyqtarja, referuar formularit të vetëvlerësimit, ka deklaruar se: *“Vlerësoj se gëzoj aftësi shumë të lartë për të identifikuar marrëdhëniet shkak-pasojë, si edhe për të analizuar se si konceptet, institutet dhe dispozitat lidhen midis tyre, ose se si ato zbatohen në një situatë të caktuar, duke arsyetuar qartë dhe saktë me qëllim që niveli i arsyetimit të plotësoj standardin e procesit të rregullt ligjor, duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve kur Gjykata Administrative e Apelit ka juridiksion fillestar për shkak të ligjeve organike që kanë specifikuar këtë gjykatë kompetente nga pikëpamja funksionale në proces, si dhe pretendimeve në ankim kur Gjykata Administrative e Apelit ka juridiksion rishikues...”*

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Gjyqtarja analizon në mënyrë të plotë dhe të qartë faktet e çështjes, për të vijuar me analizën e koncepteve ligjore që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes, mbi bazën e një zhvillimi dhe argumentimi logjik mbi mënyrën e aplikimit të tyre mbi rastin në shqyrtim. Gjyqtarja e zhvillon argumentimin e saj duke ndjekur logjikën e zhvillimit e marrëdhënies shkak-pasojë, si dhe duke u kujdesur për të marrë në analizë dhe për t'i dhënë përgjigje të argumentuar të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse, duke përmbushur të standardin e procesit të rregullt ligjor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik”, vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

⁵⁶ Vendimi nr.330, datë 11.06.2021 i Gjykatës Administrative të Apelit,

Niveli i Vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares {...} në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e saj si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A Aftësia e gjyqtares për të përballuar ngarkesën në punë.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Në nenin 48 pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar parashikohet se: “...Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi...”.

Gjithashtu, në nenin 10 pika 2, gërma b), përcaktohet se Gjykata Administrative e Apelit shqyrton në shkallë të parë, mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, si dhe raste të tjera të parashikuara me ligj. Në ligjin nr.49/2012 nuk janë përcaktuar afate për gjykimin e padive në shkallë të parë nga gjykata administrative e apelit. Por vetë ligji i posaçëm mund të parashikojë afate për gjykimin e këtyre padive në shkallë të parë nga Gjykata Administrative e Apelit.

Në nenin 51 të ligjit nr.49/2012 parashikohet se: “Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga gjykata e shkallës së

parë. 2. Vendimi i mësipërm, data dhe ora e seancës gjyqësore u njoftohen palëve rregullisht nga sekretaria gjyqësore, të paktën 10 ditë para datës së zhvillimit të seancës gjyqësore.

Në referim të dispozitave të mësipërme çështjet që janë shqyrtuar në dhomë këshillimi do të llogariten me afat ligjor 30 ditor, në kuptim të nenit 48 të ligjit, ndërsa çështjet të cilat janë shqyrtuar në seancë gjyqësore (në mungesë të një afati të posaçëm) do të llogariten me standard minimal, duke iu referuar afatit standard minimal për shqyrtimin e çështjeve në gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, afat i parashikuar në pikën 5/h të vendimit nr.261/2 datë 14.04.2010 të KLD, në të cilën përcaktohet se: “Standardi kohor i punës nënkupton realizimin e nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si më poshtë:... c) Gjykimet civile në gjykatën e apelit, jo më tej se 6 muaj”.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja ka gjykuar 91 çështje, për të cilat ligji parashikon afat ligjor dhe 60 çështje me afat standard minimal. Duke i ndarë sipas kategorive, çështjet e gjykuara tej afatit ligjor, rezultojnë si më poshtë:

- (i) 59 çështje të kategorisë “Çështje me palë kundërshtare” (tabela nr. 1) të shqyrtuar në dhomë këshillimi, kanë përfunduar jashtë afatit ligjor (30 ditë) të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012, i ndryshuar. Koha e gjykimit të tyre varion nga 96 ditë deri në 1586 ditë (afërsisht 4 vjet e 5 muaj) nga dita e shortit.
- (ii) 5 çështje nga kategoria “Çështje pa palë kundërshtare” (tabela nr. 2), me objekt “Sigurim padie”, kanë përfunduar jashtë afatit ligjor, të parashikuar nga neni 28 i ligjit 49/2012 (lidhur me kërkesat objekt sigurim padie)⁵⁷ dhe vetëm 2 çështje me të njëjtin objekt kanë përfunduar brenda afatit 5 ditor. Megjithatë po të marrim në konsideratë kohën e shkurtër të kalimit të afatit 5 ditorë për çështjen me nr. rëndor 5, (tabela nr. 2), duke zbritur ditët e pushimit, tejkalimi prej 2 ditësh do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë do të konsiderohet si e përfunduar brenda afatit ligjor 5/ditor. Nga vëzhgimi i tabelës nr.4 që i përket kategorisë së çështjeve me “Juridiksion fillestar”, konstatohet se çështja me nr. rëndor 7, me objekt “Sigurim padie” është çështje me afat ligjor dhe konstatohet se ajo ka përfunduar brenda 1 dite. Pra në total nga 8 çështje me objekt “Sigurim padie”, 4 çështje do të konsiderohet të përfunduar brenda afatit ligjor dhe 4 çështje të përfunduara jashtë afatit ligjor prej 4 ditësh.
- (iii) 25 çështje të kategorisë “Marrëdhënie pune” (tabela nr. 3), të shqyrtuar në dhomë këshillimi, kanë përfunduar jashtë afatit ligjor (30 ditë) të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012, i ndryshuar. Referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton se 7 çështje janë shqyrtuar në seancë gjyqësore. Koha e gjykimit të tyre varion nga 140 ditë deri në 2 vjet e 11 muaj nga dita e shortit.

Sa më sipër, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (**gjithsej 88 çështje**), me numrin e çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji parashikon këtë afat ligjor (**92 çështje, pasi u shtua çështja me nr.rëndor 7, tabela 4**), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar 95 % të çështjeve me afat ligjor, jashtë këtij afati.

⁵⁷Neni 28 i ligjit nr.49/2012, parashikon se: “Kërkesa për sigurimin e padisë, sipas pikave 1 dhe 2 këtij neni, duhet të shqyrtohet brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes në gjykatë. Si rregull kërkesa shqyrtohet në prani të palëve, por, në raste të ngutshme, mund të shqyrtohet edhe pa u thirrur palët. 4.Vendimi për sigurimin e padisë jepet në çdo fazë dhe shkallë të shqyrtimit gjyqësor, derisa vendimi nuk ka marrë formë të prerë.”

Gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vlerësimit e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke parashtruar se ngarkesa e çështjeve për gjykim gjatë vitit 2021 është shumë e lartë, krahasuar me numrin e gjyqtarëve që në vitin 2021 pësoi një ulje të ndjeshme për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, ku në fund të vitit 2021 mbetën vetëm 5 gjyqtarë efektivë, fakt që diktoi vështirësi të dukshme në organizmin e punës në trupa gjyqësor me tre dhe pesë gjyqtarë. Ndër të tjera gjyqtarja shprehet se: “Ligji nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” nuk parashikon afate ligjore për përfundimin e çështjeve administrative. Neni 399/2 i Kodit të Procedures Civile, parashikon afatin e arsyeshëm për përfundimin e gjykimit brenda një viti nga fillimi i tij.

Për sa i takon shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore, jam përpjekur që të shqyrtohen brenda afateve të arsyeshme dhe shtyrja e seancës është bërë vetëm me qëllim realizimin e një procesi gjyqësor të rregullt, me qëllim respektimin e parimit të kontradiktoritetit, por edhe dhënien e mundësisë kërkuarit të provojë faktet e pretenduara, duke mos e bërë këtë proces vetëm formal.

Referuar backlog që në krijimin e Gjykatës Administrative të Apelit për shkaqe të njohura që përkojnë me vendimet unifikuese datë 3/4/2013, fusha e gjerë e juridiksionit funksional të kësaj gjykate për shkak të ligjeve të tjera të posaçme që e parashikojnë si gjykate me juridiksion fillestar (gjyk e shk. 1), si dhe funksioni i saj sipas nenit 10/2/b i ligjit 49/2012 i ndryshuar, organika e saj me 5 gjyqtare efektive kjo në Dhjetor të vitit 2021, pas 2 shkarkimeve dhe 2 pezullime të gjyqtareve të tjerë, mendoj se ka shkaqe të përligjura në lidhje me gjykimin e çështjeve administrative, tej afatit të parashikuara nga neni 399/2 i K.Pr.Civile.

Pavarësisht se në vitin 2021 unë si gjyqtare raportoj kam gjykuar 151 vendime, këtu referoj se nga datat 03.02.2021-12.02.2021 kam qenë në karantine si person kontakti, 13.02.2021-27.02.2021 pozitiv Covid vetizolim, dt.01.03.2021-15-03.2021 raport mjekësor vet-izolim, 23.03.2021 - 31.03.2021 leje vjetore e pakryer për vitin 2020, dt.15.08.2021-09.09.2021 leje vjetore e vitit 2021. Për këtë vit është realizuar kjo lloj ngarkese duke patur parasysh që dy anëtarët e trupit gjykues janë shkarkuar, konkretisht B.SH u pezullua dt. 25.03.2021 nga (KPK) dhe dt.18.06.2021 u shkarkua përfundimisht me cilësinë e magjistratit K.S. Në këto kushte duke patur parasysh ngarkesën dhe rifillimin e gjykimeve me trup gjykues të ri por, dhe plotësimi i çështjeve në seancë gjyqësore dhe dhomë këshillimi me anëtarë të tjerë të trupës gjyqësore të cilat kanë dashur kohën e nevojshme për short planifikim sipas procedurave të ligjit 49/2012 i ndryshuar, ka bërë që çështjes të shtyhen në mënyrë të njëpasnjëshme, duke humbur kështu dhe afatet e parashikuara nga ligji.

Seancat pasardhëse janë caktuar në afate relativisht të afërta, në kushtet kur në Gjykatën Administrative të Apelit çështjet gjykohen me trup gjykues të përbërë nga 3 (tre) gjyqtar dhe 5 (pesë) gjyqtare për aktet normative nënligjore, ç’ka do të thotë se në caktimin e datave të gjykimeve duhet të korespondojnë planifikimet e të treve, apo dhe të pesë gjyqtareve.

Gjithashtu disa çështje rezultojnë se janë llogaritur jashtë afatit ligjor, duke llogaritur edhe periudhën e lejes së zakonshme vjetore (35 ditë kalendarike cituar sa sipër), por dhe shkaqet e arsyeshme në lidhje me mungesën e tyre në detyrë për një kohë rreth 2 muaj.

Nëse do të shikonim vitet paraardhëse, unë si gjyqtare kam mbajtur një ngarkesë të madhe në lidhje me gjykimin e çështjeve, Prill 2016-Dhjetor 2016, gjithsej 402 çështje, viti 2017, gjithsej 676 çështje, viti 2018, gjithsej 608 çështje, viti 2019, gjithsej 354 çështje, viti 2020 që përkon dhe me gjendjen e covid në gjithë globin 132 çështje (marrë shkas këtu që në qershor 2020 u shkarkuar nga KPK-ja B.K e cila ka qenë me cilësinë e anëtares së trupit

gjykues). Gjithashtu, vlerësoj se në vitin 2019 ishte largimi i pare i nje magjistrati nga trupa gjyqesore kështu që çështjet e tij iu rishqyrtuan magjistrateve të tjere duke shtuar kështu dhe më shumë gjendjen e backlog personal, kjo dhe për efekt të sistemit që nuk ndante në mënyrë të barabarte ngarkesen midis magjistrateve fakt i njohur publikisht, pasi i kam bërë publike qëndrimin tim në mbledhjet e përgjithshme të trupës gjyqesore. Pra sikundër vërehet me sy të lirë unë kam arritur të gjykoj mbi mesataren e miratuar, e cila tregon eficence të lartë. Për të gjithë periudhën e vlerësimit, duhet të mbahet parasysh në pikëzimin e këtij kriteri, si një shkak komplementar i atyre të renditura më sipër, ngarkesa me çështje gjyqesore që unë si gjyqtar kam patur, ngarkesa administrative në ushtrimin e funksioneve të zv/kryetares së kësaj gjykate (që nuk kam aplikuar asnjëherë 50% të gjykimit të çështjeve me magjistratet e tjere) që së bashku kanë ndikuar në tejkalimin e afateve ligjore. Mbajtur parasysh sa më sipër, vlerësoj se në të gjitha çështjet tejkalimi i afateve ligjore nuk ka qënë për neglizhencën time ose paaftësinë për të menaxhuar një proces gjyqësor dhe kërkoj që shpjegimet e mësipërme të mbahen parasysh në interpretimin e këtyre statistikave dhe pikëzimin e këtij kriteri. ”

Duke marrë parasysh shpjegimet e gjyqtares si dhe aktet e paraqitura, në përlllogaritjen e afateve ligjore, për të gjitha dosjet, ka fillur nga dita e shortit (pra data kur çështja ka shkuar pranë gjyqtares). Në të gjitha dosjet, në përlllogaritje do të zbriten:

- leja vjetore e muajit gusht prej 35 ditësh (ligji parashikon 25 ditë pune për gjyqtarët).
- kohën gjatë secilës gjyqtarja ka qënë me raport shëndetësore, apo në pamundësi për tu paraqitur në punë si person kontakti me Covid -19⁵⁸.

Duke vlerësuar me kujdes çdo çështje referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe shpjegimeve të gjyqtares në lidhje me shkaqet që kanë çuar në kohëzgjatjen e gjykimeve, edhe pas zbritjes së ditëve kur gjyqtarja ka qënë në pamundësi për tu paraqitur në gjykatë si dhe kohën e kryerjes së lejes së zakonshme, përsëri rezultati nuk ndryshon në lidhje me shqyrtimin e tyre brenda afatit ligjor prej 30 ditëve. Por me këtë rilllogaritje shkurtohet afati i gjykimit të secilës çështje.

Ndërsa po t'i referohemi datës kur gjyqtarja ka caktuar çështjen për shqyrtim në dhomë këshillimi (pra nga dita kur çështja është nxjerrë për gjykim), duke e krahasur me çështjet e përzgjedhura me short, rezulton se gjyqtarja ka planifikuar përgjithësisht seancën për shqyrtimin e saj brenda afatit ligjor të shqyrtimit prej 30 ditëve dhe mosshqyrtimi brenda këtij afati përgjithësisht ka ardhur për arsye të përligjura (mosformimi i trupit gjykues).

Sa më sipër, në total nga 92 çështje gjithsej të cilat kanë të parashikuar afat ligjor për përfundimin e tyre, edhe pas ripërlllogaritjeve, rezulton që gjyqtarja **ka përfunduar jashtë afatit ligjor 88 çështje ose 95 % të çështjeve** që parashikojnë afat ligjor për përfundimin e

⁵⁸ Referuar shpjegimeve të gjyqtares por edhe akteve të paraqitura nga Gjykata Administrative e Apelit, me shkresën nr. 54 Prot, datë 26.01.2022, protokolluar në KLGJ, me nr. 146/1 prot, datë 27.01.2022, rezulton se gjyqtarja gjatë vitit 2021 ka qënë me raport shëndetësore për këto periudha nga data 29 janar 2021 e deri në fund të shkurtit 2021. Gjithashtu, gjatë muajit mars nga data 01.03.2021- 15.03.2021 ka qënë me raport mjekësor vet-izolim dhe nga data 23.03.2021-31.03.2021 ka kryer lejen e zakonshme, të vitit 2020, të mbetur e pakryer gjatë vitit 2020. Referuar vendimit nr.376, datë 26.04.2021 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, rezulton se gjyqtarja gjatë kësaj periudhe ka qënë edhe në procesin e rivlerësimit kalimtar (për të cilën janë zhvilluar 3 seanca, në datat 25.03.2021, 22.04.2021 dhe 26.04.2021), ku raporti i parë mbi rezultatet e hetimit i është njoftuar në datë 12.02.2021 dhe raporti i dyti i është njoftuar në datë 14.04.2021. Gjithashtu, nga data 20.05.2021- 24.05.2021 gjyqtarja ka kryer një pjesë të lejes së zakonshme, nga data 02.06.2021- 04.06.2021 ka qënë me raport shëndetësore dhe nga data 05.07.2021- 07.07.2021 ka qënë përsëri me raport shëndetësor.

tyre. Referuar tabelës së pikëzimit për këtë tregues, të përcaktuar në rregulloren nr.264/2019, kjo përqindje ekuivalentohen me 3 pikë.

Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjithave burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Në rastin konkret, në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtarja ka përfunduar në total për periudhës 1-vjeçare objekt vlerësimi 151 çështje, nga të cilat të vlerësimit 126 çështje janë çështje me palë kundërshtare (94 çështje administrative dhe 32 marrëdhënie pune (tabela 1, 3 dhe 4).

Në lidhje me rritjen e volumit të punës si dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, rezultoi se gjatë vitit 2021 gjyqtarës i janë caktuar me short si relatores 868 çështje me palë kundërshtare, të ardhura dhe si pasojë e rishortimit të çështjeve të gjyqtarëve të shkarkuar nga KPA dhe KPK. Gjatë vitit 2021, gjyqtarja nuk është paraqitur në punë për arsye shëndetësore si dhe për shkak të kryerjes së një pjese të lejes së zakonshme, të pakryer gjatë vitit 2020, për një periudhë gati rreth 2 muaj. Gjithashtu, ajo ka qenë e angazhuar me procesin e vlerësimit kalimtar nga mesi i muajit shkurt deri në datë 26.04.2021 (datë kur nga KPK është dhënë vendimi për konfirmimin e saj në detyrë). Gjithashtu, ka rezultuar se gjatë vitit 2021 në Gjykatën Administrative të Apelit janë shkarkuar 2 gjyqtarë, që kanë qenë në trup gjykues me të, konkretisht në datë 25.03.2021 është pezulluar gjyqtari *B.SH (me vendim të KPK)* dhe në datë 18.06.2021 është shkarkuar me vendim të KPA gjyqtari *K.S*, të cilët kanë sjellë shtyrjen e seancave të gjykimit (si ato të planifikuara në dhomë këshillimi edhe ato në seancë gjyqësore) ashtu edhe rishortimin e dosjeve të tyre dhe plotësimin e trupit gjykues me gjyqtarë të tjerë. Gjithashtu, gjyqtarja është caktuar në pozicionin e zëvendëskryetares së Gjykatës në datë 09.07.2021, pas shkarkimit nga KPK në datë 08.07.2021 të zëvendëskryetares Lindita Sinanaj, duke ushtruar detyrat e plota të kryetarit të gjykatës në kushtet kur më parë kryetari i kësaj gjykate ishte shkarkuar nga KPA.

Lidhur me këtë tregues gjyqtarja paraqiti kundërshtime dhe kërkoi pikëzimin e saj maksimal, duke pretenduar se ashtu siç është arsyetuar në projektraport ajo ka qenë në pamundësi për tu paraqitur në punë për një periudhë gati 2 mujore për arsye shëndetësore apo arsye të tjera të përligjura, të cilat kanë çuar në shqyrtimin e çështjeve jashtë afatit, duke referuar në kundërshtimet e saj kohën e gjykimit të 35 çështjeve me palë kundërshtare dhe 16 çështje marrëdhënie pune, të konsideruara me afat ligjor, ku rezultojnë edhe shkaqet e shtyrjes së seancave në dhomë këshillimi, të cilat kanë qenë gjithmonë të përligjura. Gjithashtu, pretendoi se çështjet me objekt- sigurim padie kanë qenë çështje të ardhura mbi bazën e ankimit, e për pasojë nuk janë nga ato që duhet të shqyrtohen brenda 5 ditëve, duke renditur këtu edhe afatin e gjykimit të këtyre çështjeve nga shortimi deri në marrjen e vendimit.

Lidhur me këtë pretendim, Këshilli vlerëson të theksojë se në llogaritjen e afatit të gjykimit të çështjeve të cilat janë konsideruar me afat ligjor, është marrë data e shortimit, referuar tabelave statistikore të përcjella nga Gjykata Administrative e Apelit, të cilat ndër të tjera nuk kanë përcaktuar nëse çështjet me objekt sigurim padie kanë ardhur me shkak ankimi. Nga verifikimi i këtyre tabelave lidhur me çështjet me palë kundërshtare dhe ato marrëdhënie

pune, konstatohet se përqindja e mësipërme nuk ndryshon. Në lidhje me çështjet me objekt sigurim, padie, edhe nëse i marrim të ardhura me shkak ankimi, të cilat më pas janë shqyrtuar në dhomë këshillimi nga gjykata konstatohet se nga dita e shortit deri në dhënien e vendimit, duke e marrë afatin e shqyrtimit 30 ditë, janë shqyrtuar jashtë afatit vetëm 3 çështje, duke e ulur kështu numrin e çështjeve të shqyrtuar jashtë afatit në 87 çështje, nga 92 çështje që parashikojnë afat ligjore. Megjithatë ky ndryshim, nuk ndryshon ndjeshëm përqindjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor dhe as pikëzimin e saj sipas Metodologjisë së Pikëzimit.

Në lidhje me afatin e gjykimit nga momenti i nxjerrjes së çështjet për gjykim ashtu siç është theksuar më sipër, është konstatuar se përgjithësisht gjyqtarja ka respektuar afatin 30 ditorë të shqyrtimit dhe këto seanca janë shtyrë vetëm për shkaqe të përligjura, të pavarura nga gjyqtarja (mosformim të trupit gjykues)

KONKLuzioni

Analiza e të dhënave statistikore nuk bëhet nga vlerësuesi në mënyrë matematikore, por është një analizë logjike e të dhënave burimore. Në përcaktimin e nivelit të pikëzimit konsiderohen në rastin konkret:

- i)* ngarkesa e gjyqtarës si relatores dhe anëtare (në total ka gjykuar 151 çështje si relatores, nga të cilat 126 janë çështje me palë kundërshtare dhe 199 çështje si anëtare, nga të cilat 27 çështje i përkasin juridiksionit fillestar);
- ii)* vetëvlerësimi i gjyqtarës lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;
- iii)* numri i lartë i çështjeve me afat ligjor ku gjyqtarja ka qenë relatores pasi rezulton se ka përfunduar 92 çështje me afat ligjor, të cilat përbëjnë 61 % të çështjeve të shqyrtuara prej saj në vitin 2021;
- iv)* si dhe duke pasur në vëmendje se caktimi i datës dhe orës së gjykimit të çështjes së ardhur mbi ankim të palës/palëve, bëhet nga gjyqtari relator, në përputhje me kalendarin e tij të shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën, sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit.
- v)* mungesën e gjyqtarës në punë për arsye shëndetësore apo për shkak të kryerjes së një pjese të lejes së zakonshme deri në muajin qershor 2021, për një periudhë rreth 2 muaj, si dhe angazhimin e saj në procesin e rivlerësimit kalimtar gjatë vitit 2021;
- vi)* pezullimin dhe shkarkimin nga detyra e dy gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Administrativ të cilët kanë qenë në trup gjykues me gjyqtaren, si dhe angazhimi i tyre në procesin e rivlerësimit kalimtar gjatë vitit 2021;
- vii)* pozicioni i gjyqtarës si zëvendëskryetare e Gjykatës nga data 09.07.2021, për një periudhë prej 6 muajsh gjatë vitit 2021, e cila në mungesë të kryetarit, ka ushtruar me kompetenca të plota detyrën e kryetarit të gjykatës.

Sa më sipër, referuar analizës logjike të të dhënave vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivele të ndryshëm se pikëzimi që rezulton nga të dhënat statistikore, duke u pikëzuar me 9 pikë, por kursesi nuk duhet të shkojë në një pikëzim maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares për treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, vlerësohet e lartë, brenda marzhit “11-20 %”, dhe pikëzohet me 9 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Sikurse u analizua edhe në treguesin e mësipërm, çështjet gjyqësore të shqyrtuara në seancë gjyqësore do të llogariten si çështje me standard minimal kohor. Po kështu, edhe çështjet e juridiksionit fillestar, do të konsiderohen çështje me standard minimal kohor, në kushtet kur këto çështje gjykohen në bazë të kompetencës funksionale të gjykatës, duke e gjykuar si gjykatë e shkallës së parë.

Plotësimi i standardeve minimale kohore nënkupton respektimin nga ana e gjyqtarit të afateve orientuese, për çdo kategori çështjes, të përcaktuar në vendimin nr.261/2, datë 14.4.2010, të KLD, ende në fuqi. Për të pikëzuar këtë tregues, vlerësimi bëhet referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor, me numrin total të çështjeve të gjykuara. Në vendimin nr.261/2, datë 14.04.2010 ku përcaktohen kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore, nuk rezulton të jetë përcaktuar standardi minimal kohor për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative në gjykatën e apelit, por rezulton që për gjykatat e apeli të jetë përcaktuar standardi minimal kohor vetëm për gjykimet civile, duke u përcaktuar ky afat, jo më tej se 6 muaj. Gjithashtu, në këtë vendim janë parashikuar afate orientuese për gjykimin e çështjeve administrative në shkallë të parë dhe pikërisht në pikën 5, shkronja “c” parashikohet se “Gjykimet e mosmarrëveshje administrative në gjykatën e shkallës së parë, jo më tej se 1 muaj”.

Pavarësisht këtij parashikimi, në raportin e vlerësimit referimi lidhur me standardet minimale kohore është bërë sipas pikës 5, shkronja “h”, kjo duke pasur parasysh specifikën e gjykimeve administrative në gjykatën e apelit, po kështu edhe duke pasur parasysh qëndrimin e Këshillit në vlerësimet e mëparshëm, për të gjithë gjyqtarët.

Afati i përfundimit të gjykimit për gjykatën administrative të apelit, për çështjet për të cilat nuk ka afat ligjor gjykimi, është konsideruar periudha kohore nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim nga gjyqtari relator deri në datën e shpalljes së vendimit, në referim kjo të Udhëzuesit “Për plotësimin e tabelave me të dhënat statistikore për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”, miratuar me vendimin nr.60, datë 30.01.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, si dhe nga përpunimi i të dhënave statistikore, rezulton se çështjet në përgjithësi kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor, me përjashtim të:

- (i) 18 çështje tek tabela nr.1, kategoria “Çështje me palë kundërshtare”, dhe konkretisht çështjet me numër rendor 5, 6, 7, 13, 22, 23, 24, 41, 43, 44, 49, 54, 55, 65, 68, 80, 81 dhe 82, të cilat kanë përfunduar jashtë afatit 6 (gjashtë) mujor të parashikuar në pikën

5/h të vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010 të KLD, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim. Çështja me nr. rendor 24, rezulton të ketë mbaruar për 7 muaj e 6 ditë. Nëse do zbresim rreth 60 ditë gjatë cilave gjyqtarja ka qenë me raport shëndetësor apo leje vjetore, çështja rezulton e gjykuar për 5 muaj e 6 ditë, **brenda** afatit 6 muaj të parashikuar në pikën 5/h të vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010 të KLD. Gjithashtu, çështja me nr. rendor 13, është shqyrtuar për një afat prej 8 muaj e 14 ditë. Pasur parasysh datën e regjistrimit të saj si dhe datën e përfundimit, datë 09.06.2021, nëse do të zbresin kohën gjatë secilës gjyqtarja gjatë kësaj periudhe ka qenë me raport shëndetësor për rreth 2 muaj (gjatë muajit shkurt – mars 2021) si dhe faktin se në muajin maj ka kryer një pjesë të lejes vjetore (për rreth 5 ditë, data 20.05.2021-24-05.2021) si dhe 3 ditë me raport shëndetësorë (në datë 02- 04.06.2021) , atëherë rezulton se çështja ka përfunduar për rreth 6 muaj e 6 ditë, tejkalim i cili vlerësohet i pakonsiderueshëm, duke marrë parasysh edhe numrin e lartë të seancave të kryer për këtë çështje. Pra, në këtë kategori janë shqyrtuar jashtë standardit minimal kohor 16 çështje nga 23 prej tyre.

(ii) 4 çështje tek tabela nr.3, kategoria “*Marrëdhënie pune*”, dhe konkretisht çështjet me nr. rendor 5, 21, 31 dhe 32 kanë përfunduar jashtë afatit 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në pikën 5/h të vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010 të KLD, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim. Çështja me nr. rendor 6, rezulton të ketë përfunduar për 7 muaj e 4 ditë, dhe çështja me nr.rendor 23, rezulton të ketë përfunduar për 7 muaj e 23 ditë. Po të zbresim rreth 60 ditë gjatë cilave gjyqtarja ka qenë me raport shëndetësor apo leje vjetore të pakryer të vitit 2020 si dhe lejen e kryer gjatë muajit gusht 2021, çështjet rezultojnë të jenë gjykuar brenda 6 muajve, të parashikuar në pikën 5/h të vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010 të KLD. Ndërsa çështjeve të tjera edhe nëse këtyre çështjeve do t’i zbresim rreth 60 ditë gjatë cilave gjyqtarja ka qenë me raport shëndetësor apo leje vjetore, çështjet rezultojnë të gjykuara **jashtë** afatit 6 muaj të parashikuar në pikën 5/h të vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010 të KLD. Pra, në këtë kategori janë shqyrtuar jashtë standardit minimal kohor 4 çështje.

(iii) 2 çështje tek tabela nr.4, kategoria e çështjeve “*Juridiksion fillestar*”, dhe konkretisht çështjet me nr. 2 dhe 4 rendor kanë përfunduar jashtë afatit 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në pikën 5/h të vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010, i llogaritur ky afat nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim.

Edhe nëse këtyre çështjeve do t’i zbresim rreth 60 ditë gjatë cilave gjyqtarja ka qenë me raport shëndetësor apo leje vjetore, çështjet rezultojnë të gjykuara **jashtë** afatit 6 muaj të parashikuar në pikën 5/h të vendimit nr.261/2, datë 14.04.2010 të KLD.

Në total, referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor (22 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, pa përfshirë çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi (59 çështje), gjyqtarja rezulton që të ketë gjykuar **37 % të çështjeve në tejkalim të standardit minimal kohor**. Sipas “*Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit*”, të miratuar me vendimin me Nr. 264, datë 21.11.2019 të KLGJ, përqindja matematikore prej 37 % përkon me nivelin e vlerësimit 2 (dy) pikë (30- 40 % - 2 pikë).

Gjyqtarja në Formularin e Integruar të Vlerësimit e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke parashtruar ndër të tjera se “*Në gjykatën administrative të apelit gjykohen çështje me karakter të ndryshëm nga njera-tjera, të cilat paraqesin vështiresi në*

gjykimin e tyre sepse kanë shumë problematika në vetvete, të cilat kërkojnë secila kohën e tyre.

Në çështje të cilat shyrtohen në seancë gjyqësore, ka çështje të tilla të cilat kërkojnë ekspertime dhe riekspertime dhe nuk mund të përfundojnë brenda 30 ditësh. Afati 30 ditor i përcaktuar në vendimin nr. 261/2 datë 14.04.2010, është objektivisht i pamundur, për shkak të numrit të lartë të çështjeve të shortuara dhe të gjykuara në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Ngarkesa reale në punë është mbi 5 – fishin e standardit minimal të miratuar (aresye te detajuara sa sipër).

Në kohëzgjatjen e një procesi gjyqësor ndikon natyra e çështjes dhe kërkesat që palët paraqesin gjatë zhvillimit të gjykimit, të cilat nuk mund të refuzohen me qëllimin që gjykimi të përfundojë në një kohë të shpejtë. Gjithashtu edhe periudha e muajit gusht ndikon në kohëzgjatjen e çështjes (si dhe aresyeve te detajuara me sipër).

Dua të theksoj, se përgjatë periudhës së vlerësimit asnjëherë nuk kam treguar paaftësi në mirë menaxhimin e afateve ligjore ose orientuese, por jam përpjekur që procesi gjyqësor të zhvillohet duke respektuar të gjithë komponentët e një procesi të rregullt gjyqësor, duke mos i kthyer afatet në qëllim në vetvete, në dëm të parimeve të tjera të këtij procesi.”

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”*

Lidhur me përcaktimin e aspektit sasior në vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, nuk rezulton të jetë përcaktuar një standard orientues në aspektin sasior për gjykimet e mosmarrëveshjeve administrative në apel, por vetëm për gjyqtarin e shkallës së parë të dhomës civile, që gjykon në seksionin administrativ⁵⁹. Kështu, për analogji, pasur parasysh faktin se jemi përpara gjykimit në apel me natyrë administrative do t'i referohemi standardit sasior të punës së përcaktuar për gjyqtarin e apelit të dhomës civile, standard ky i mbajtur edhe për gjyqtarët e tjerë. Sipas pikës 3 shkronja “i”, të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit⁶⁰, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së apelit i dhomës civile, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 gjykime çështjesh civile.

Ndërsa në pikën 3, shkronja “k” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve, të miratuar me vendimin nr.261/2, datë 14.04.2010 të KLD, përcaktohet se; *“Kryetari i gjykatës në funksionin e gjyqtarit nënkupton realizimin nga ata brenda një viti kalendarik të një ngarkese minimale respektivisht në masën e 40 % të ngarkesës minimale të punës së gjyqtarit të asaj gjykate”.*

⁵⁹ Pika 3, gërma “c” i Vendimit nr.261/1, datë 14.04.2010 të KLD përcakton se; *“Standardi sasior i punës, nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale si më poshtë; c. Gjyqtari i shkallës së parë i dhomës civile, si relator, i seksionit administrative, jo më pak se 150 gjykime çështjet që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative.”*

⁶⁰ Pika 3, gërma “i” i Vendimit nr.261/1, datë 14.04.2010 të KLD përcakton se; *“Standardi sasior i punës, nënkupton realizimin nga gjyqtari brenda një viti kalendarik të një ngarkese pune minimale si më poshtë; i. Gjyqtari i gjykatës së apelit i dhomës civile, si relator, jo më pas se 200 gjykime çështjes civile”.*

Ka rezultuar se gjyqtarja Enkelenda {...} është caktuar në detyrën e zëvendëskryetares në datë 09.07.2021, pas shkarkimit të gjyqtares Lindita Sinanaj me vendimin nr.417, datë 08.07.2021 të KPK, duke ushtruar kështu detyrën e kryetares me kompetenca të plota, në kushtet kur me vendim e datës 18.06.2021 të KPA është shkruar Z. Kastriot Selita, me detyrë kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit. Pra rezulton se ajo ka ushtruar detyrën e kryetares për një periudhë 6 mujore, brenda periudhës së vlerësimit, çka nënkupton një ngarkesë sasiore gjatë vitit prej jo më pak se 140 çështje.

Gjyqtarja rezultoi se gjatë vitit 2021 ka përfunduar në total 151 çështje si relatores, duke e tejkalluar standardin minimal të ngarkesës me 11 çështje apo 7 %.

Nga ana tjetër, në vlerësimin e këtij treguesi, vlen të mbahet parasysh se në afatin e gjykimit të disa çështjeve ka ndikuar edhe periudha në të cilën veprimtaria gjyqësore ka qenë e pezulluar, për shkak të vendimeve nr. 127, datë 10.03.2020, “Për pezullimin e veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, nr. 128, datë 24.03.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë”, nr.133, datë 06.04.2020 “Për vijimin e pezullimit të veprimtarisë dhe shërbimeve gjyqësore në të gjitha gjykatat në Republikën e Shqipërisë” të Këshillit të Lartë Gjyqësor, aktit normativ nr. 9, datë 25.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta në fushën e veprimtarisë gjyqësore gjatë kohëzgjatjes së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19”, miratuar me ligjin nr.30/2020.

Gjithashtu, ka ndikuar edhe procesi i vlerësimit kalimtar, ku vetë gjyqtarja por edhe dy anëtarë të trupit gjykues të saj kanë qenë të angazhuar me procesin e vlerësimit kalimtar⁶¹ gjatë periudhës objekt vlerësimi.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara tejt standardit me numrin total të çështjeve që rezulton në masën 39 %, pavarësisht ngarkesës në punë, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes për përfundimin e gjykimit në 62.7 % të tyre duke respektuar standardin minimal kohor; (ii) faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit që lidhen me periudhën në të cilën veprimtaria gjyqësore ka qenë e pezulluar për shkak të pandemisë Covid 19; (iii) angazhimin e gjyqtares brenda periudhës së vlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar, deri në dhënien nga KPK të vendimit për konfirmimin në detyrë, në datë 26.04.2021; iv) pamundësinë e saj për tu paraqitur në punë për arsye shëndetësore për një periudhë gati 2 muaj të plotë (iv) angazhimin e gjyqtarëve të tjerë të Gjykatës Administrative të Apelit në procesin e rivlerësimit kalimtar gjatë vitit 2020 dhe 2021; (v) rritjen e papritur të volumit të çështjes për shkak të rishortimit të çështjeve të gjyqtarëve të larguar nga detyra brenda periudhës së vlerësimit, (iii) tejkallimin e standardit sasior të zbatueshëm me vetëm 11 çështje, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me një nivel të ndryshëm pikëzimi nga ai që përkon me llogaritjen matematikore, duke e pikëzuar me 5 pikë.

⁶¹ Sipas vendimit nr. 376 datë më 26.4.2021 të KPK, rezulton se gjyqtares i është njoftuar rezultati i hetimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale dhe më pas në datë 14.04.2021 i është njoftuar mbi hetimet shitesë dhe rezultatin shitesë të hetimit të kryer. Gjithashtu, me vendimin nr. 361, datë 25.03.2021 të KPK është vendosur shkarkimi i gjyqtares BSh dhe me vendimin nr. 15/2021, date 18.06.2021 të KPA është vendosur shkarkimi i gjyqtarit K.S.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore”, gjyqtarja vlerësohet në nivelin “Mbi 0- 10%”, dhe pikëzohet me 5 pikë.

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik si dhe nga përpunimi i detajuar i të dhënave statistikore, rezultojnë se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjyqimi, është më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar për gjysmën e kategorive të çështjeve. Konkretisht,

- Në kategorinë “Çështje me palë kundërshtarë”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 403 ditë (1 vit e 1 muaj e 13 ditë), pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 muaj, duke e llogaritur këtë afat nga data e nxjerrës për gjykim. Ndërsa pas një rillogaritje të bërë, referuar tabelave statistikore, duke zbritur këtu për çdo çështje, në varësi të datës së nxjerrës për gjykim periudhën e kryerjes së lejes së zakonshme si dhe kohën gjatë secilës gjyqtarja ka qenë me raport shëndetësorë, rezultojnë të jetë 279 ditë (gati 9 muaj e 10 ditë), pra më e gjatë se standardi minimal kohor i miratuar.
- Në kategorinë “Çështje pa palë kundërshtarë”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është 0.7 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej 4 muaj.
- Në kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, është 299 ditë (9 muaj 25 ditë), pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 muaj, duke e llogaritur këtë afat nga data e nxjerrës për gjykim. Megjithatë, po të zbrisim nga ky afat për secilën çështje, në varësi të datës së nxjerrës për gjykim, periudhën e kryerjes së lejes së zakonshme, prej 35 ditë kalendarike, kohën gjatë secilës gjyqtarja ka qenë me raport shëndetësorë përgjatë vitit 2021 (gati dy muaj), si dhe periudhën e kohës që veprimtari gjyqësorë ka qenë e pezulluar gjatë vitit 2020 për shkak të pandemisë Covid 19, rezultojnë se kjo kategori çështjes ka përfunduar brenda afatit 6 muaj.
- Në kategorinë e çështjeve “Juridiksion fillestar”, tabela nr.4⁶², pas një rillogaritje të kohës që i dedikohet çdo çështje (përpunimit të statistikave), duke e llogaritur afatin nga momenti i nxjerrjes së çështjes për gjykim, rezultojnë se për 12 çështje për të cilat nuk parashikohet afat ligjor për shqyrtimin e tyre, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, është 151.4 ditë (rreth 5 muaj e 1 ditë), pra më e shkurtër se standardi minimal kohor i miratuar prej 6 muaj, duke e llogaritur këtë afat nga data e nxjerrës për gjykim⁶³. Në këtë afat nuk është llogaritur zbritja e kohës gjatë secilës gjyqtarja ka qenë me raport shëndetësorë apo periudhën gjatë secilës ka kryer lejen e zakonshme. Nëse do të bëhet kjo zbritje, koha e gjyqimit për këtë kategori do të rezultoi më e vogël.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë. Gjyqtarja është shprehur se: “Me qëllim respektimin e parimit të procesit të

⁶² Në raportin Analitik koha mesatare për kategorinë “Juridiksion fillestar” rezultojnë të jetë llogaritur **222 ditë**. Referuar të dhënave statistikore, nuk rezultojnë se ky afat është llogaritur nga dita e nxjerrjes së çështjes për gjykim edhe në kushtet kur rezultoi se nga 13 çështje të “Juridiksionin fillestar”, 2 prej tyre janë shqyrtuar tej standardit minimal kohorë prej 6 muajsh të përcaktuar në vendimin nr.261/2 të KLD.

rregullt gjyqësor të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës, çmoj se kam aftësi shumë të larta për të përfunduar çështjet në afat, sipas kategorisë përkatëse, në raport me standartet minimale kohore të miratuara, për çdo kategori, pavarësisht shkaqeve të ndërvarura, objektive që e ka karakterizuar këtë gjykatë vitet e fundit 2020-2021 pandemia, problemet e mia shëndetësore si dhe gjendja aktuale e cila gjykon çështjet me 5 gjyqtare nga 13 që është organika (shpjeguar me detaje sa sipër).

Përgjithsisht çështjet janë depozituar në afatet ligjore të përcaktuara, përveç atyre çështjeve të cilat janë depozituar disa ditë në vonesë për shkaqe të përlligjura, të tilla si raportit mjekësor, lejet, mosparaqitja në punë e anëtarëve të trupit gjykues, etj.

PS : Ajo që është e rëndësishme të merret në konsideratë është fakti se viti 2021 ka qënë një situatë jo normale jo vetëm në Gjykatën Administrative të Apelit, pasi gjyqtarët i janë nënshtruar procesit të vetingut dhe prezenca e tyre në gjykatë apo nëpër gjykime ka qënë shumë e pakët.”

KONKLUZIONI

Kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara është më e gjatë se standardi për gjysmën e kategoritë e çështjeve, duke u tejkalluar standardi kohor minimal i gjykimit me rreth thuhetse 3 muaj e 10 ditë tek gjykimet administrative me palë kundërshtare, dhe me thuhetse 3 muaj në çështjet marrëdhënie pune. Referuar metodologjisë së Pikëzimit, kjo llogaritje matematikore përkon me një pikëzim prej 3 pikësh. Por duke marrë në konsideratë faktin se në kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune”, po të zbresin periudhën gjatë secilës gjyqtarja ka qënë në pamundësi për tu paraqitur në gjykatë për arsye shëndetësore, kryerjen e lejes së zakonshme, si dhe periudhën e pezullimit të veprimtarisë gjyqësore gjatë vitit 2020 për shkak të pandemisë, rezulton koha mesatare e gjykimit të këtyre çështjeve është brenda 6 muajve, duke bërë që koha mesatare që i dedikohet çdo çështje të jetë më shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve, llogaritje e cila sipas Metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 4 pikë. Por duke marrë në konsideratë volumin e çështjeve, specifikat e gjykimit në apelin administrativ në lidhje me organizimin e punës për shkak se gjykimi zhvillohet me trup gjykues të përbërë nga tre dhe pesë gjyqtarë, angazhimin e saj dhe të anëtarëve të trupit të saj gjykues gjatë këtij viti në procesin e rivlerësimit kalimtar (vetting), funksionin e gjyqtarës si zëvendëskryetare e Gjykatës si dhe faktin se përgjithësisht gjyqtarja ka treguar kujdes për zhvillimin e gjykimit brenda afateve, vlerësohet që niveli i vlerësimit duhet të jetë më i lartë se ai që i korespondon pikëzimit të përcaktuar në tabelën përkatëse, duke arritur në pikëzimin maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” vlerësohet “Më e shkurtër ose e barabartë me standardit për të gjitha kategoritë e çështjeve”, dhe pikëzohet me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara si relatores (151), me numrin e çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik 2021 (868) është 17.4 %.

Në formularin e integruar të vlerësimit, gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë. Gjyqtarja është shprehur se: *“Në lidhje me këtë rubrikë do të doja që të vlerësoheshin dhe vitet paraardhëse ku ka qenë kohë e artë dhe për Gjykatën Administrative të Apelit me organike të plotësuar prej 13 vetesh, sipas treguesve sasiorë vitet 2017-2019 kjo gjykatë ka patur gjendjen e saj më të mirë në të gjykuar, ku gjykonte më shumë çështje ardhur mbi bazë ankimi ku kjo gjykatë ka funksion rishikues. Duke iu referuar të dhënave statistikore vlerësoj se zotëroj aftësi shumë të larta për përfundimin e çështjeve gjyqësore, duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve të përfunduara nga gjyqtari, pavarësisht kohës së caktimit të tyre, me numrin e çështjeve që i janë caktuar brenda një viti kalendarik (referoj me detaje të dhënave dhe shpjegimeve sipas rubrikave të sipërcituara).”*

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit përqindja e mësipërme (17.4%) pikëzohet me 2 pikë. Referuar përsëri të njëjtit akt nënligjor, pikëzimi për këtë tregues bëhet duke vlerësuar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Mbi këtë bazë, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës së gjyqtarit. Kjo e fundit merret në konsideratë vetëm në rast se gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës, i përcaktuar për gjyqtarin e gjykatës së apelit dhoma civile.

Në rastin konkret rezulton që gjyqtarja ka gjykuar më shumë se standardi minimal i punës me vetëm 11 çështje, pasi gjyqtarja gjatë vitit 2021 ka përfunduar në total 151 çështje si relatores, nga 140 çështje të përcaktuara si standard minimal sasior sipas pikës 3, gërma “k” të Aneksit 1 të Vlerësimit, në kushtet kur për një periudhë 6 mujore ajo ka ushtruar detyrën e kryetares së gjykatës. Duhet përmendur fakti që thuhet se 2 muaj (shkurt, mars 2021) gjyqtarja ka qenë me raport mjekësor apo leje vjetore si dhe deri në fund të muajit prill ka qenë e angazhuar gjithashtu me procesin e rivlerësimit kalimtar, rrethana të cilat e kanë bërë atë të pamundur për tu paraqitur në punë, çka ul numrin e çështjeve që ajo duhet të gjykonte brenda kësaj periudhe me rreth 117 çështje, duke bërë kështu që ajo ta tejkalojë standardin minimal me 34 çështje.

Gjithashtu, siç u theksua më lartë, rezultoi se gjatë 6 mujorit të parë të vitit 2021 janë pezulluar dhe shkarkuar me vendim të KPK dhe KPA dy gjyqtarë të cilët kanë qenë në trup gjykues me gjyqtaren {...}, rrethana të cilat kanë ndikuar në moszhvillimin në kohë të gjykimeve të planifikuara apo në pamundësi të planifikimit të çështjeve të tjera, pas shortimit me anëtarë të tjerë të trupit gjykues për shkak të ngarkesës së tyre.

Lidhur me këtë tregues, gjyqtarja paraqiti kundërshtime dhe kërkoi pikëzimin maksimal me 10 pikë, duke pretenduar se në llogarijen e këtij treguesi nuk duhet të vlerësohen vetëm çështjet në cilësinë e relatorit por edhe çështjet në cilësinë e antëtarit të cilat në total janë 199 çështje, të gjykuara me tre dhe pesë anëtar, shkaqe këto që çojnë në rendimentin e gjyqtarit.

Gjithashtu, pretendoi se duke gjykuar 127 çështje me palë kundërshtare, ajo e ka tejkaluar standardin në treguesin sasior me 50 % në fuqi sipas “Kritereve matëse të veprimtarisë gjyqësore” të miratuar me vendimin nr.261/2 të vitit 2010 të KLD, duke zbritur këtu periudhën prej 2 muaj, që ka qenë me raport shëndetësore, 10 ditë leje vjetore të pakryere si dhe procesin e rivlerësimit kalimtar.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësuar në tërësinë e tyre, si dhe të dhënave statistikore nga të cilat rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjatë gjithë vitit 2021, 151 çështje si relatore, (nga të cilat 127 çështje janë me palë kundërshtare), pra duke mos e tejkaluar më shumë se 50% treguesin sasior në fuqi sipas “Kritereve matëse të veprimtarisë gjyqësore” miratuar me vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD, duke e marrë vitin e plotë, pa zbritur periudhën që gjyqtarja ka qenë në pamundësi për tu paraqitur në punë për arsye shëndetësore, por nga ana tjetër duke pasur parasysh edhe ngarkesën e saj si anëtare (ka përfunduar 199 çështje në këtë cilësi) rendimenti i përfundimit të çështjeve nga gjyqtarja, pavarësisht se rezulton të jetë 17.3%, vlerësohej të pikëzohet me një nivel të ndryshëm nga ai përket përqindjes së pikëzimit referuar Metodologjisë së Pikëzimit, duke arritur deri në pikëzimin maksimale, pasi shkaqet që kanë ndikuar në rendimentin e gjyqtares lidhen me organizmin e gjykatës në trupa gjyqësore me tre dhe pesë gjyqtarë dhe problematikave të lindura për shkak të largimit të gjyqtarëve nga procesi i vettingut, pamundësisë së gjyqtares për tu paraqitur në punë për arsye shëndetësore, angazhimin e saj në procesin e rivlerësimit kalimtar.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” vlerësohet “ + 99 %”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsytimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin ligjor 7 ditor të parashikuar në nenin 55 të ligjit nr. 49/2012, është si më poshtë:

- Në kategorinë “Çështje me palë kundërshtare” koha mesatare e arsytimit është 10.4 ditë, **pra më e gjatë** se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012.
- Në kategorinë “Çështje pa palë kundërshtare” koha mesatare e arsytimit është 11.4 ditë, **pra më e gjatë** se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012.
- Në kategorinë e çështjeve “Marrëdhënie pune” koha mesatare e arsytimit të vendimit është 9.4 ditë, **pra më e gjatë** se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012.

- Në kategorinë e çështjeve “*Juridiksion fillestar*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 15.7 ditë, **pra më e gjatë** se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012.

Nga ana tjetër, afati 7 ditor i arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar i përcaktuar në nenin 55 të ligjit nr. 49/2012, është shumë më i shkurtër krahasuar me afatin 20 ditor të arsyetimit të vendimeve gjyqësore civile sipas parashikimeve të nenit 308 paragrafi 2 i Kodit të Procedurës Civile (pas ndryshimeve me ligjin nr.38/2017, datë 30.03.2017). Edhe pse ligji nr.49/2012 përbën ligj të posaçëm dhe sipas nenit 1 pika 2 të tij, dispozitat e K.Pr.Civile zbatohen vetëm në rastet kur nuk parashikohet ndryshe në të, përsëri duket se pas ndryshimeve të K.Pr.Civile dhe shkaqeve që kanë çuar ligjvënësin në përcaktimin e afatit 20 ditor të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ka një mungesë harmonizimi mes qëllimit të parashikimit të këtij afati me afatin e arsyetimit të parashikuar në ligjin nr.49/2012. Referuar sa më sipër, rezulton afati i arsyetimit të vendimeve për të gjithë kategoritë e çështjeve është më i shkurtër se 20 ditë.

Referuar shkresës së ardhur nga Gjykata Administrative e Apelit⁶⁴ ku tregohet data e depozitimit të vendimit në sekretari nga gjyqtarja, rezulton që vendimi është depozituar në afat, por ka mbetur për firmën e njërit prej anëtarëve të trupit gjykues apo për shkak se gjyqtarja ka qenë me raport. Pas rillogaritjes së kohës mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore referuar të dhënave të ardhura më shkresë nga Gjykata rezultoi se:

- Në kategorinë “*Çështje me palë kundërshtare*” koha mesatare e arsyetimit është rreth 6.6 ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012.
- Në kategorinë “*Çështje pa palë kundërshtare*” koha mesatare e arsyetimit është rreth 7 ditë, **pra aq sa** afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012.
- Në kategorinë e çështjeve “*Marrëdhënie pune*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit është rreth 6.3 ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012.
- Në kategorinë e çështjeve “*Juridiksion fillestar*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit është rreth 8.3 ditë, **pra më e gjatë** se afati procedural i posaçëm prej 7 ditësh i parashikuar nga neni 55, i ligjit 49/2012, duke e tejkaluar këtë afat me 1 ditë, tejkallim i cili vlerësohet i pakonsiderueshëm, e për pasojë do të vlerësohet se është arsyetuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 55 të ligjit 49/2012.

Për sa më sipër, me këto të dhëna koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor, rezulton më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjithë kategoritë e çështjeve.

Gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në shkallë shumë të lartë. Ajo është shprehur se: “*Duke iu referuar treguesit mesatar të kohës së arsyetimit për të gjitha vendimet gjyqësore të dhëna gjatë periudhës së vlerësimit (por dhe më parë), vlerësoj se gëzoj aftësi shumë të lartë për të arsyetuar në kohë sa më të shpejtë vendimet gjyqësore. E karakterizoj vetes si një magjistrate që kam depozituar pothuajse 90% të rasteve brenda afateve të parashikuara nga ligji material, përveç ndonjë shkak ligjor të argumentuar siç janë nënshkrimi i anëtarëve të trupit gjykues*

⁶⁴ Shkresa nr. 54 Prot, datë 26.01.2022, protokolluar në KLGJ me nr. 146/1 prot, datë 27.01.2022.

jashtë këtyre afateve apo mosprezenca për arsye objektive apo të ligjshme me raport mjekësor.

Shumica e vendimeve janë arsyetuar brenda afatit ligjor. Në kohën e arsyetimit të vendimit ndikon ngarkesa dhe numri i lartë i vendimeve të arsyetuara. Çështjet me prova dhe material voluminoze kërkojnë kohë më të gjatë për arsyetimin e vendimit. ”

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, në kushtet kur rezultoi se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësor, rezulton më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi; Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” vlerësohet se gjyqtarja duhet të pikëzohet me 15 pikë, pasi kjo kohë është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve të analizuar.

2.B Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive.

Referuar tabelave me të dhëna statistikore dhe raportit analitik, rezulton se nuk ka të dhëna për numrin e seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, *pasi te numri i seancave janë pasqyruar edhe seancat përgatitore në çështjet e kategorisë “Juridiksion fillestar”,* pasi këto të dhëna nuk gjenerohen në mënyrë elektronike. Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, *treguesi i numrit të seancave për çështje bëhet pjesë e vlerësimit etik dhe profesional kur statistikatat mundësohen në rrugë elektronike. Nëse kjo nuk është e mundur, ky tregues për vlerësimin dhe zvarritjen e gjykimeve, identifikohet dhe vlerësohet vetëm për çështjet e zgjedhura me short.*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se vendimet për të gjitha çështjet e përzgjedhura me short janë marrë në dhomë këshillimi. Asnjë çështje nuk rezulton të ketë shkuar për gjykim në seancë gjyqësore. Për marrjen e vendimit janë zhvilluar disa seanca në dhomë këshillimi, të cilat janë shtyrë për shkak të mosformimit të trupit gjykues. Sa më sipër, në mungesë të të dhënave për numrin e seancave gjyqësore, vlerësoj se numri i seancave do të konsiderohet 1-3 seanca dhe shkallë shumë e lartë e aftësisë.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, konkretisht të seancave të caktuara në dhomë këshillimi, duke iu referuar akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se:

- Gjyqtarja subjekt vlerësimi ka mbikëqyrur dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët.

- Moszhvillimi i seancave të planifikuara në dhomë këshillimi kanë qenë për shkak të mosformimit të trupit gjykues. Konkretisht evidentohet se si shkaqe të moszhvillimit të seancave dhe më pas caktimit të seancave të rradhës në dhomë këshillimi, mosformimi i trupit gjykues për shkak të pamundësisë shëndetësore të relatores ose shkarkimin e një prej anëtarëve të trupit gjykues në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve, komunikimi për palët i zëvendësimit të një prej anëtarëve të trupit gjykues me qëllim garantimin e procesit të rregullt ligjor.
- **Konstatohet se nga ana e gjyqtarëve merren masat me qëllim shmangien e seancave joproductive.** Konkretisht, në të gjitha çështjet e përzgjedhura e short rezulton se gjyqtarja jo vetëm ka ngarkuar sekretarinë gjyqësore për njoftimin e palëve ndërgjyqëse për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes **në dhomë këshillimi**, por ka bërë edhe sqarimin se deri në 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes në dhomë këshillimi palët kanë të drejtë të paraqesin parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ankimit dhe kundërankimit (*në kuptim të nenit 49 pika 2 të ligjit nr.49/2012*).

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin “*Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive*”, rezulton se nuk ka të dhëna nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, sepse të gjitha çështjet janë gjykuar në dhomë këshillimi. Në këto kushte, do të vlerësohet se numri i seancave është 1 (një). Nëse do i referohemi numrit mesatar të seancave në dhomë këshillimi, shkaqet që kanë çuar në moszhvillimin e tyre në datën e planifikuar, masat e marra nga gjyqtarja për caktimin e një date tjetër të afërt për zhvillimin e seancës në dhomë këshillimi si dhe masat e nevojshme të marra prej saj për shmangien e seancave joproductive, për planifikimin dhe zhvillimin e seancave me efektivitet, vlerësohet se gjyqtarja ka treguar aftësi shumë të larta për të kryer procedurat gjyqësore.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, në kushtet kur nuk ka të dhëna për numrin e seancave gjyqësore, për sa kohë që të gjitha vendimet e zgjedhura me short janë shqyrtuar në dhomë këshillimi, do të konsiderohet se numri i seancave gjyqësore është 1- 3 dhe shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproductive është e lartë, prandaj gjyqtarja duhet të vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarëve dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarëve për këtë tregues, është “1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 6 (gjashtë) çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, të gjitha janë shqyrtuar në dhomë këshillimi.

Të gjitha çështjet e shqyrtuara janë në bazë të ankimeve kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë, gjyqtarja ka vënë në lëvizje çështjet, duke përgatitur relacionin përkatës, si dhe duke urdhëruar njoftimin e palëve për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes të paktën 15 ditë përpara.

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara në dhomë këshillimi janë çelur relativisht me vonesa nga 19 minuta deri në 1 orë, por në asnjë rast nuk konstatohet që fillimi me vonesë i seancës të jetë bërë shkak për dështimin e seancës në dhomë këshillimi. Shkaku i vonesës në zhvillimin e seancës në dhomë këshillimi, në rastet kur ai është relatuar nga gjyqtarja, lidhet me pjesëmarrjen e trupit gjykues në gjykime të tjera të përfunduara tej afatit të parashikuar apo pjesëmarrjen në seancë dëgjimore në KPK të ndonjërit prej anëtarëve të trupit gjykues.

Gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në shkallë shumë të lartë. Në formularin e vetëvlerësimit ajo shprehet se: *“Vlerësoj se gëzoj aftësi shumë të lartë për të qënë efektiv në kryerjen e veprimeve procedurale të tilla si: vënia në lëvizje e dosjes në kohë; kryerja e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë, duke marrë parasysh caktimin e afateve për të metat e ankimit; planifikimi dhe zhvillimi i seancës në dhomë këshillimi efektive; dokumentimi i vendimeve dhe veprimeve të tjera procedurale; drejtimi i një procesi të rregullt gjyqësor, duke orientuar drejt debatin mes palëve, duke u shprehur qartë, me urdhra dhe vendime të ndërmjetme për çdo kërkesë të tyre; fillimi i seancave pa vonesë; regjistrimi audio i seancave; ndjekja me rigoroze të fazave në të cilat kalon shqyrtimi gjyqësor; orientimi i palëve për t’ju referuar praktikave të ngjashme unifikuese nga Gjykata e Lartë me qëllim investimin me vend të Gjykatës së Apelit duke reaguuar dhe me heqjen dore nga ankimi, ketu behet fjale dhe për ato çështje që kanë mbetur pa objekt nga backlog i krijuar ndër vite.”*

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në raportin analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja jo gjithmonë ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me afate ligjore, por nga ana tjetër, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit në apel administrativ në dhomë këshillimi.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 20 pikë.*

2.C Aftësia e gjyqtarës për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se aktet e dosjeve janë

renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Rendi i akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (*sipas datës së aktit*) brenda të njëjtës kategori.

Rendi i akteve në çështjet e shqyrtuar fillon me aktin e shortit, vijon me vendimin për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, lista e shpalljeve të gjyqimit, relacioni mbi çështjen administrative, procesverbalet për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi (të renditura sipas datave) dhe vendimi gjyqësor përfundimtar. Në dy dosje⁶⁵ ndodhet edhe kërkesa e palëve për përsheptimin e çështjes.

Gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në shkallë shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Rendi i akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykatat më të larta. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata në përputhje me veprimet procedurale të kryera prej saj (*njoftimet, procesverbalet e çdo seancë për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, vendimet gjyqësore*), si dhe aktet e paraqitura nga palët (*provat mbi të cilat mbështesin kërkesat për sigurim padie apo për përsheptim procesi*). Në disa dosje, bashkëlidhur gjendet edhe CD audio e seancave në dhomë këshillimi.

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në shkallë shumë të lartë.

KONKLUZIONI

⁶⁵ Vendimi nr.427, datë 14.09.2021 dhe Vendimi nr.330, datë 11.06.2021 të Gjykatës Administrative të Apelit

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Nivelin e vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Pikët	Niveli i vlerësimit
94	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A Etika në punë

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk evidentohet të ketë të dhëna që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtares. Nuk evidentohen që nga ana e gjyqtares të ketë shfaqje të sjelljeve që tregojnë mungesë respekti, vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje, apo qasje të papërshtatshme dhe ofensive, gjatë ushtrimit të detyrës.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 841/1 prot., datë 20.04.2022, rezulton se për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, për gjyqtaren {...} janë paraqitur 10 (dhjetë) ankesa. Lidhur me shkaqet e ankesave dhe rezultatet e verifikimit të tyre, referuar materialeve të dërguara nga ILD, rezulton si më poshtë:

- Ankuesja znj. LP i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e regjistruar me nr. 3988 prot., datë 28.10.2021. Gjithashtu ankuesja ka depozituar pranë KLGJ-së ankesën e regjistruar me nr. 242 prot., datë 15.01.2020, e cila është përcjellë pranë ILD-së për kompetencë trajtimi të mëtejshme, regjistruar me nr. 1563 prot., datë 08.07.2020. Pas shqyrtimit të ankesës Inspektori i Lartë i

Drejtësisë ka miratuar vendimin nr. 3988/2 prot. datë 31.03.2022 *“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara së paraqitur nga shtetasja LP”*.

- Ankuesit z. **LG, znj. IG, z. EM etj** i janë drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e regjistruar pranë ILD-së me nr. 150 prot., datë 21.01.2021. Pas shqyrtimit të ankesës Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar vendimin nr. 150/3 prot. datë 19.04.2022 *“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasit z. LG, znj. IG,, z. EM etj.”*
- Ankuesi z. **AS** i është drejtuar në rrugë elektronike Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me dy ankesa regjistruar me nr. 2480 prot., datë 24.05.2021 dhe nr. 2480/1 prot., datë 24.05.2021. Pas përfundimit të procedurave të verifikimit Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar vendimin nr. 2480 prot. datë 28.10.2021 *“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara së paraqitur nga shtetasi z. AS”*.
- Ankuesi z. **GjSh** i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me dy ankesa regjistruar me nr. 4125 prot., datë 16.11.2021. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar vendimin nr. 4125/3 prot. datë 08.03.2021 *“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. GjSh”*.
- Ankuesi z. **PQ** i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e regjistruar me nr. 48 prot., datë 12.01.2021. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar vendimin nr. 48/3 prot. datë 15.06.2021 *“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. PQ”*.
- **Ministri i Financave dhe Ekonomisë** ka depozituar pranë ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë ankesën e regjistruar me nr. 2844 prot., datë 08.10.2018. Më pas kjo ankesë është përcjellë për kompetencë trajtimi të mëtejshëm pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë regjistruar me nr. 369 prot., datë 29.01.202. Pas përfundimit të procedurave të verifikimit Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar vendimin nr. 359/2 prot. datë 19.05.2021 *“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë”*.
- Ankuesi z. **GjXh** i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e regjistruar me nr. 1153 prot., datë 19.02.2021. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar vendimin nr. 2141 prot. datë 22.04.2021 *“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. GjXh”*.
- Ankuesi z. **SB** i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e regjistruar me nr. 4312 prot., datë 06.12.2021, nr.3082 prot., datë 05.07.2021, nr.3083, datë 05.07.2021. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar vendimin nr. 1441/1 prot. datë 02.06.2021 *“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga shtetasi z. SB”*.
- Komanda e Forcës Detare i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e regjistruar me nr. 4114 prot., datë 15.11.2021. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar vendimin nr. 1416/7 prot. datë 11.01.2023 *“Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga Komanda e Forcës Detare”*.
- Ankuesi z. **ED** i është drejtuar Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesën e regjistruar me nr. 4089 prot., datë 10.11.2021. Pas shqyrtimit fillestar të ankesës Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar vendimin nr. 2398/8 prot. datë 23.01.2023 *“Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasi ED”*.

Ankesat e paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit, të cilat janë trajtuar nga ILD, nuk rezultojnë të kenë evidentuar elementë të cenimit të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Referuar kërkesës për informacion mbi vendimet përfundimtare për masat disiplinore të dhëna ndaj gjyqtares {...} Inspektori i Lartë i Drejtësisë me shkresën me nr.841/1 prot., datë 20.04.2022 ka sqaruar se gjatë vitit 2021 nuk ka kërkuar në asnjë rast marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtares {...}. Gjithashtu sa i përket vendimeve përfundimtare për masa disiplinore të marra gjatë vitit 2021 nga organet kompetente nuk është depozituar asnjë vendim i tillë.

Gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në shkallë shumë të lartë.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton të ketë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 35 pikë.

3.B Integriteti i gjyqtares

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjteti.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me shkresën nr. 841/1 prot., datë 20.04.2022, nr.841/2 rot., datë 14.06.2022 dhe shkresën me nr.333/1 prot., datë 24.01.2023 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka dërguar informacionin në lidhje me verifikimin e ankesave dhe masave disiplinore ndaj gjyqtares {...}. ***Pas verifikimeve përkatëse ka rezultuar se të gjitha ankesat për gjyqtaren {...} janë arkivuar dhe në përmbajtje të vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nuk është konstatuar asnjë e dhënë në lidhje me treguesin e integritetit të gjyqtarit.*** Gjithashtu referuar kërkesës për informacion mbi vendimet përfundimtare për masa disiplinore të dhëna ndaj gjyqtares {...} rezulton se ndaj saj nuk është depozituar asnjë vendim i tillë, për rrjedhojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka sqaruar se nuk disponon informacionin e kërkuar.

Sa më sipër, në lidhje me verifikimin e ankesave dhe masave disiplinore ndaj gjyqtares {...}, nuk rezultuan të dhëna negative në lidhje me të gjitha komponentët e integritetit.

Nga raporti i ILDKPKI, përcjellë në KLGJ me shkresën nr. 723/24 prot., datë 24.03.2022, konkludohet se : a) *deklarimi është i saktë dhe në përputhje me ligjin*; b) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë*; c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; d) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; e) *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit*.

Gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në shkallë shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtares.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin e gjyqtarit, vlerësohet se gjyqtarja duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtares në treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe duhet të pikëzohet me 40 pikë.

3.C Paanësia e gjyqtares

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk u konstatua përdorimi i gjuhës diskriminuese apo tendencë për paragjykime gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të dhëna prej gjyqtares {...}. Gjuha e përdorur është korrekte. Asnjë prej dokumenteve ligjorë të vëzhguara nuk lidhen me çështje të grupeve në nevojë, të pakicave apo të të miturve. I njëjti konstatim rezulton edhe nga aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, përfshirë këtu regjistrimet e seancave me mjete audio.

Gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në shkallë shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarës.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën 01 janar 2021-31 dhjetor 2021, janë paraqitur nga palët 5 (pesë) kërkesa për përjashtimin e gjyqtarës {...}, nga të cilat nuk ka asnjë kërkesë të pranuar për përjashtimin e saj nga gjykimi. Ndërkohë, sipas të dhënave statistikore rezulton se gjyqtarja subjekt vlerësimi ka hequr dorë në 45 çështje, nga të cilat 27 prej tyre janë pranuar dhe 19 kërkesa janë rrëzuar.

Për këto arsye, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, vlerësohet si “I pakonsiderueshëm” duke qenë se nuk rezulton asnjë kërkesë e pranuar për përjashtimin e gjyqtarës nga gjykimi.

Gjyqtarja e ka vlerësuar treguesin “numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” si të pakonsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, vlerësohet se ky numër është “I pakonsiderueshëm”, prandaj pikëzohet me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarës në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A Aftësia e komunikimit.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtares për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor si dhe në rastet e ndërhyrjes së saj për shmangien e seancave joproduktive, konstatohet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre apo në lidhje me disponimin e gjykatës me vendime të ndjermjetme. Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize dhe duke respektuar normat e komunikimit zyrtar si dhe duke evidentuar në mënyrë të qartë aktin që këkohet nga të tretët.

Gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në shkallë shumë të lartë.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, presumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, presumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “I lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B Aftësia për të bashkëpunuar

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Nuk ka të dhëna negative, të cilat të kenë cënuar kujdesin për ruajtjen e konfidencialitetit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të cilat ai vihet në dijeni për shkak të funksionit.

Gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në shkallë shumë të lartë.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në shkallë shumë të lartë.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C Gatishmëria e gjyqtarës për t’u angazhuar në veprimtari të tjera.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarës në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja nuk ka marrë pjesë në asnjë aktivitet trajnues në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e ekspertes, lehtësueses apo pjesëmarrëses.⁶⁶

Gjithashtu referuar formularit të integruar të vlerësimit, lidhur me trajnimet jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, rezulton se gjyqtarja ka qenë pjesëmarrëse në telekonferencën ndërkombëtare të organizuar nga “Antitrust Laë Spring Meeting”, të zhvilluar në datat 23-26 Mars 2021, konferencë në përfundim të së cilës gjyqtarja është vlerësuar me 13 kredite. Gjithashtu evidentohet se gjyqtarja ka marrë pjesë edhe në Konferencën e Nëntëmbëdhjetë Ndërkombëtare me temë: “Shkenca Sociale dhe Natyrore-Sfidat Globale 2021”, e zhvilluar në Lisbonë më datë 23 Dhjetor 2021, në përfundim të së cilës gjyqtarja është pajisur me certifikatë pjesëmarrje.

Gjyqtarja ka marrë pjesë në 5 ditë trainimi gjithsej.

Gjyqtarja e ka vlerësuar këtë tregues në shkallë shumë të lartë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin së drejtës civile dhe administrative, gjithsej 2 aktivitete të zhvilluara për 5 ditë trajnim.

Pjesëmarrja e gjyqtarës në trajnime dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale është nga 5-40 ditë në vit (për periudhën e vlerësimit viti 2021) duke u pikëzuar me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarës për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

⁶⁶Shkresa me nr. 293/4 Prot., datë 27.05.2022 e Shkollës së Magjistraturës.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtarja {...} përgjatë vitit kalendarik 2021, nuk ka marrë pjesë në asnjë aktivitet trajnues pranë Shkollës së Magjistraturës, në rolin e ekspertes apo lehtësueses.

Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

Në formularin e vetëvlerësimit gjyqtarja shprehet: *“Sikunder u citua sa sipër dhe është përmbledhur me detaje në jete shkrimin tim nuk kam aplikuar kurre në Shkollën e Magjistratures për të qene me cilesine e ekspertes apo/lehtesues kete te drejte e kam ushtruar në Fakultetin e Drejtësisë, Universitetin e Tiranës, por kjo nuk do të thote se nuk e shikoj si mundesi në te ardhmen.”*

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja duhet të pikëzohet me 3 pikë.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin *“disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”* gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtares në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik dhe dosjes personale të gjyqtares {...} rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë apo veprimtari të tjera, të tilla si pjesëmarrje në konferenca shkencore, fjalime publike, prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit etj. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja ka deklaruar dhe rezulton të ketë marrë pjesë në këto aktivitete;

- (i) Lektore në Universitetin e Tiranës, Fakultetin e Drejtësisë, në projektin e miratuar dhe realizuar nga Departamenti i së Drejtës Civile, me temë: *“Ligji dhe problemet praktike në marrëdhëniet kontraktore”*, sipas vërtetimit⁶⁷ me nr.1017/2 prot., datë 15.12.2021.
- (ii) Lektore në Fakultetin e Drejtësisë, në programin e studimeve “Bachelor”, e drejtë biznesi, për vitin akademik 2020-2021, në lëndët: *“E drejtë civile I, II dhe E Drejta Civile III”*⁶⁸.
- (iii) Gjyqtarja ka qenë lektore pranë Tirana Business University College në datë 02 Dhjetor 2021, në leksionin me temë: *“Ligji shqiptar për mbrojtjen e konkurrencës dhe standardet e aplikimit të tij nga gjykatat shqiptare”*.
- (iv) Gjyqtarja është angazhuar si lektore në projektin *“Ligji dhe problemet praktike në marrëdhëniet kontraktore (viti 2021)”* të zhvilluar në Fakultetin e Drejtësisë, fakt që provohet me vërtetimin nr. 1017/2 prot, datë 15.12.2021, lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë UT.
- (v) Pjesëmarrëse në konferencën ndërkombëtare të organizuar nga *“Antitrust Laë Spring Meeting”*, të zhvilluar në datat 23-26 Mars 2021.
- (vi) Pjesëmarrëse në Konferencën e Nëntëmbëdhjetë Ndërkombëtare me temë: *“Shkencat Sociale dhe Natyrore-Sfidat Globale 2021”*, e zhvilluar në datë 23 dhjetor 2021 në Lisbonë.

Në formularin e vetëvlerësimit gjyqtarja shprehet *“Sikundër u përmend në rubrikat e lartpërmendura unë kam titullin “Doktor i Shkencave” dhe për të marrë këtë titull më është dashur të bëj shkrime në gazeta/revista internacionale me faktor impakti, 3 konferenca ndërkombëtare etj. Pas këtij titulli sikundër citova me lart unë jam angazhuar me cilësine e lektoreve së jashtme në Fakultetin e Drejtësisë. Po ricitoj (këto kanë qenë pjesë e CV-së time ndër vite e cila është përditësuar se fundmi), petagoge e jashtme në shkurt 2007-2008, 2008-2009, 2009-2010 në SHLUP Justinisani i I, Tiranë në lëndën « E Drejta Civile » dhe « E drejta e Punes ». Në vitin akademik 2018-2019 angazhuar si petagoge e jashtme pranë Departamentit të së Drejtës Civile në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në lëndën « E drejta e Sigurimeve », po kështu angazhuar me cilësinë e lektoreve në disa projekte të miratuara dhe realizuara nga Departamenti i së Drejtës Civile, konkretisht « Ligji dhe problemet praktike në marrëdhëniet kontraktore (viti 2018), « Ligji dhe problemet në marrëdhëniet kontraktore » (viti 2020), Ligji dhe problemet praktike në marrëdhëniet kontraktore (viti 2021). Botimi në Revisten Balkan Journal of Interdisciplinary Research , janar 2022 me faktor impakti me teme « Evoluimi i parimit të konfliktit të interesit në administratën shtetërore në Shqipëri pas reformave administrative realizuara pas viteve 90 ». Së fundmi pjesëmarrëse në Konferencën Ndërkombëtare me temë « Seksioni i ligjit për mbrojtjen e konkurrencës ».”*

Referuar sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi

⁶⁷ Vërtetimi nr.1017/2 prot., datë 15.12.2021, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë është i administruar në dosjen personale të gjyqtarës si dhe i është bashkëlidhur formularit të integruar të vetëvlerësimit të gjyqtarit, dërguar nga gjyqtarja subjekt vlerësimi.

⁶⁸ Në vërtetimin nr.137 prot., datë 16.06.2022 lëshuar nga Tirana Business University College pasqyrohet: *“Gjatë vitit akademik 2020-2021 Znj.{...} është aktivizuar si lektore e ftuar në Fakultetin e Drejtësisë në programin e studimeve Bachelor në “E Drejtë Biznesi” në lëndët: “E drejta Civile I, II dhe E Drejta Civile III. Znj.{...} ka me një përvojë të pasur si gjyqtare në Gjykatën e Apelit Administrativ ka trajtuar tema të rëndësishme të legjislacionit civil shqiptar: 1. Kuadri ligjor për kthimin dhe kompesimin e pronave ish pronarëve dhe praktika gjyqësore. 2. E drejta e pronës e parë në këndvështrimin e Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (neni 1, Protokollin 1). 3. Insituti i trashëgimisë në këndvështrimin e Vendimeve Uifikuuese të Gjykatës së Lartë. 4. Kontratat për kalimin e pronësisë dhe praktika gjyqësore lidhur me pavlefshërinë e tyre absolute ose relative.”*

të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtaren {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja {...} të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera të kësaj natyre gjatë periudhës së vlerësimit.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtares në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, rezulton se gjyqtarja ka botuar artikullin me temë “*Trajtimi historik i prokurorit Publik në Shqipëri nga vitet 90 e deri me sot*”, pranuar dhe prezantuar në konferencën Ndërkombëtare të Lisbonës ICSNS XIX-Lisbon 28.12. 2021.

Gjyqtarja ka deklaruar në formularin e vetëvlerësimit si dhe ka depozituar prova në lidhje me angazhimin e saj në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, gjatë karrierës së saj, të cilat nuk i përkasin vitit 2021, si:

- *Ekstradimi si një e drejtë, në kuadër të të drejtave të individit “Kudri Ligjor Shqiptar”*, prezantuar në datë 21-22 Dhjetor **2015**.
- *“Praktikat e Trajtimin të dëmit dhe Shperblimit në Kontratat e Sigurimit të Detyrueshem në Sektorin e Transportit”*, bashkëautore, botuar në revistën “Academic Journal of Interdisciplinary Studies, Rome Itali, Gusht **2015** me ISSN.
- *Trajnimit teorik dhe praktik i studentëve me dëmshpërblimin e dëmeve jo monetare në sigurimet e detyrueshme*“, me bashkëautorsi, publikuar në Revista Shkencore Kombëtare, publikuar në datë 28.04.2015, si pjesëmarrëse në Konferencën “Edukimi Klinik Juridik, Ndërtimi i Aftësive Praktike të Studenteve të Juridikut dhe Metodave të Mësimdhënies të Orientuara në Praktike “.
- « *Evoluimi i parimit të konfliktit të interesit në administratën shtetërore në Shqipëri pas reformave administrative realizuara pas viteve 90*”, botuar në Revistën “Balkan Journal of Interdisciplinary Research”, në Janar **2022**, me ISSN .

Por duke qenë se këto publikime janë jashtë periudhës së vlerësimit 2021, nuk do të merren në konsideratë.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit, gjyqtarja për këtë tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë, për shkak se rezultojnë të dhëna për publikime ligjore akademike gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2021- 31.12.2021.

Angazhimi i ndihmësmagjistrates dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Publikime ligjore akademike” rezulton angazhimi i gjyqtarës dhe për këtë tregues pikëzohet me 5 pikë.

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
98	Shkëlqyeshëm

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarës	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarës	94	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	98	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	392	Shkëlqyeshëm

REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93 pika 5 shkronja “ç” të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuar dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtarja {...}, pavarësisht ngarkesës së çështjeve, duhet të organizojë punën dhe menaxhojë kohën, duke i

dhënë prioritet shqyrtimit të çështjeve për të cilat ligji parashikon afat brenda të cilit ato duhet të gjykohen. Gjyqtarja duhet të mbajnë në konsideratë pjesëmarrjen në formimin vazhdues në Shkollën e Magjistraturës, si pjesmarrëse, lehtësuese dhe eksperte, në veprimtari ndërinstytucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2021 - 31 DHJETOR 2021

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES				Pikët total	Niveli i vlerësimit	
				100	Shkëlqyeshëm	
Treguesit	Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë		
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 3 pikë	

		gjqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim			Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtarja 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES				Pikët total	Niveli i vlerësimi
				94	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i	21-30%	9	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë

		kryetarit			11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	5	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtares	Mbi +99%	10	Tej standardit : Nën 81%- 2 pikë Mbi 81-87% - 4 pikë

		3.Mendimi përfundimtar i kryetarit			Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1.Të dhënat statistikore 2.Vetëvlerësimi i gjyqtares 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtares për të kryer	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të	1.Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura	1-3 seanca		Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtares:

procedural gjyqësore	nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	me short 2.Vetëvlerësimi i gjyqtares 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit	dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1.Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2.Vetëvlerësimi i gjyqtares 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtares për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1.Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2.Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1.Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2.Vetëvlerësimi i gjyqtares	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtares: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE			Pikët total	Niveli i vlerësimit	
			100	Shkëlqyeshëm	
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarës 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarës 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarës: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtarës	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarës 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtarës : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtarës	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuuese	1. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 2. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë

					Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtares	1.Të dhënat statistikore 2.Vetëvlerësimi i gjyqtares 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtares: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1.Vetëvlerësimi i gjyqtares 2.Mendimi përfundimtar i kryetarit 3.Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim 4.Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1.Vetëvlerësimi i gjyqtares 2.Mendimi përfundimtar i kryetarit 3.Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë

		4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short			
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtares 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtares për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtares në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtares 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtarja	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)	20	Pjesëmarrja e gjyqtares: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtares 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtares në	1. Vetëvlerësimi i			Nuk ka të dhëna – 3 pikë

	veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	<p>gjqtares</p> <p>2. Mendimi përfundimtar i kryetarit</p> <p>3. Dosja personale e gjqtares</p> <p>4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjqtares</p>	Ka të dhëna	5	Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	<p>1. Dosja personale e gjqtares</p> <p>2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj</p>	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT			392		
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARES			Shkëlqyeshëm		

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR